




PARLAMENTI DHE PËRFAQËSIMI POLITIK

RAPORT MONITORUES I KUVENDIT PËR VITIN 2017

FRIEDRICH
EBERT
STIFTUNG

ISP
INSTITUTI I STUDIUMEVE POLITIKE



PARLAMENTI DHE PËRFAQËSIMI POLITIK

RAPORT MONITORUES I KUVENDIT PËR VITIN 2017

AFRIM KRASNIQI

EKIPI REALIZUES

Afrim KRASNIQI, Koordinator
Edlira Gjoni, Metodologjia
Rigels Xhemollari, Monitorimi
Rudina Niklekaj, Monitorimi
Adela Xhafa, Monitorimi
Brunilda Brati, Monitorimi

Realizuar nga Instituti i Studimeve Politike
Mundesuar nga Friedrich Ebert Stiftung
Dizajn dhe faqesje: EDUAR 

REALIZUAR NGA INSTITUTI I STUDIMEVE POLITIKE www.isp.com.al
MUNDËSUAR NGA FONDACIONI “FRIEDRICH EBERT” www.fes-tirana.org


Ky projekt u mbështetet financiarisht nga Friedrich Ebert Stiftung. Opinionet, gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet e shprehura janë të Institutit të Studimeve Politike dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht ato të FES.

PËRMBAJTJA

1. HYRJA	4
2. GJETJET KRYESORE DHE REKOMANDIMET	8
3. KUVENDI I SHQIPËRISË, MONITORIMI DHE TREGUESIT KRYESORË	16
4. PROBLEMATIKA POLITIKE DHE ADMINISTRATIVE E KUVENDIT	30
5. TË DHËNA MBI AKTIVITETIN DHE BILANCIN LEGJISLATIV	44
6. TË DHËNA MBI DEPUTETET: KONTRIBUTI NE SEANCA DHE NE KOMISIONET PARLAMENTARE	56

1

HYRJA



Instituti i Studimeve Politike (ISP) me mbështetjen e fondacionit gjerman Friedrich-Ebert- Stiftung (FES) realizoi në periudhën janar – qershor 2017 monitorimin e institucionit të Kuvendit të Shqipërisë. ISP ka kryer edhe gjatë vitit 2016 monitorimin e aktivitetit të deputetëve (angazhimet në seancat plenare dhe në komisionet parlamentare), por projekti i mbështetur nga FES është më i plotë, përfshin institucionin, aktivitetet dhe bilancin parlamentar.

- Monitorimi bazohet në dy elementë thelbësorë: sa përfaqësues është parlamenti në raport me qytetarët zgjedhës, dhe nivelin e zbatimit të legjislacionit që rregullon punën e Kuvendit, deputetëve, të drejtat dhe detyrimet e tyre. Monitorimi është aktiv, përfshin punën në seanca plenare dhe në komisione, aktivitetin publik parlamentar, zhvillimet më të rëndësishme politike që lidhen me parlamentin, si dhe tregues krahasimor mbi bilancin e punës së tij gjatë 2017 dhe viteve të mëparshme. Pjesë e monitorimit janë edhe praktikat e punës së Kuvendit, zbatimi i Statutit të Deputetit dhe Rregullores së Kuvendit, zbatimi i parimeve të transparencës publike, etj.

Në funksion të monitorimit ISP pati takime zyrtare dhe më pas një sërë korrespondencash zyrtare me Kuvendin, në përpjekje për të kryer një monitorim sa më efektiv dhe për të pasqyruar sa më realisht problematikën e dukshme (publike) dhe të padukshme (jo publike) të aktivitetit të Kuvendit dhe të deputetëve. ISP adresoi në një raport paraprak gjetjet e para të monitorimit më 30 mars 2017, si dhe një raport më të plotë më 30 maj 2017. Raporti iu dërgua zyrtarisht Kuvendit dhe përmes tij, grupeve parlamentare. Kuvendi, përmes Sekretarit të Përgjithshëm bëri komente mbi raportin paraprak me 23.06.2017.

- Komentet në tërësi paraqesin pikëpamjen e Kuvendit mbi rastet kritike të cituara në raport, si dhe përpjekjet e stafit për të justifikuar problematikën kritike. Vlen të theksohet fakti se komentet zinin mbi 50% të madhësisë së vetë Raportit Monitorues, ndërkohë që trajtonin vetëm 10 nga rreth 40 problemikat e trajtuara në raportin monitorues. Në komentet zyrtare të Kuvendit nuk gjendet asnjë deklaratë pranuese, vlerësuese e reflektuese mbi gjetjet e tjera kritike të raportit të pa komentuara, si dhe nuk trajtohen asnjë nga të dhënat e monitorimit që lidhen me punën e deputetëve, grupeve parlamentare dhe komisioneve parlamentare. Përveç vlerësimit pozitiv për korrektesën dhe korrespondencën mbi raportin, kjo mënyrë e njëanshme dhe e paplotë e trajtimit të problematikave të Kuvendit


konfirmon në thelb gjetjet kritike të ISP dhe shpreh nevojën për një trajtim më institucional dhe përfshirës të diskutimeve të tilla brenda institucionit të Kuvendit.

Në korrik 2017 ISP bëri lançimin publik të raportit monitorues, duke reflektuar edhe sugjerimet apo komentet e ndryshme të ardhura nga parlamenti, grupet parlamentare, ekspertët e jashtëm të ISP apo deputetë me përvojë në jetën parlamentare. Në aktivitetin lancues morën pjesë edhe deputetë të parlamentit aktual (të rizgjedhur edhe më 25 qershor), përfshirë dy kryetaret e Komisioneve Parlamentare, Vasilika Hysi dhe Albana Vokshi.

- Synimi i ISP është bashkëpunimi aktiv me deputetët dhe Kuvendin për problematikat e konstatuara në vijim dhe për përmirësim edhe të aspekteve të monitorimit, në mënyrë që procesi tërësor i monitorimit të ketë impakt pozitiv për parlamentin dhe qytetarët. Në këtë aspekt, prezenca dhe bashkëpunimi me komisionet parlamentare, deputetët dhe Kuvendin mbeten pjesë e rëndësishme e procesit të monitorimit dhe aktivitetit të ISP.

Pjesë e grupit monitorues të ISP ishin ekspertë ligjorë, të rinj të diplomuar në shkencat politike dhe në shkencat juridike, gazetarë, etj. Ekipi u drejtua nga Profesor Afrim Krasniqi, drejtor i Institutit të Studimeve Politike. Të dhënat e raportit monitorues janë reflektim i punës së këtij grupi dhe pasqyrojnë pikëpamjet e tij dhe të ISP mbi aktivitetin e Kuvendit dhe të deputetëve.





GJETJET KRYESORE DHE REKOMANDIMET

Ekipi monitorues i Institutit të Studimeve Politike do të vijojë monitorimin e parlamentit edhe në vitet e ardhshme. Në funksion të rritjes së transparencës dhe të hapjes së parlamentit ndaj qytetarëve dhe interesit publik, si dhe në funksion të lidhjeve më organike midis deputetëve, votuesve të tyre, zonave zgjedhore dhe përgjegjësisë kushtetuese e politike të tyre, ISP mendon se Kuvendi do të duhet të reflektojë ndryshime të rëndësishme në strukturë, mentalitet, sjellje dhe raportet publike; se deputetët, grupet parlamentare dhe partitë politike duhet të kenë një raport shumë më transparent dhe llogaridhënës ndaj qytetarit votues dhe publikut të interesuar.

1. ISP konstaton se **Ligji mbi Statutin e Deputetit dhe Rregullorja e Kuvendit** kanë nevojë për përmirësime të ndjeshme, për tu përshtatur më mirë me pritshmëritë e sotme dhe sfidat e të ardhmes. ISP sugjeron ndërhyrje në rregulloren e Kuvendit dhe në ligjin mbi statusin e deputetit për të zgjidhur ligjërisht një sërë problematikash të evidentuara në këtë raport, ose të konstatuara edhe partnerë të tjerë civilë apo vetë institucioni, në mënyrë që përmes bazës ligjore të krijohen kushte për standarde më të larta të punës së parlamentit, për efektivitet më të lartë dhe për nivel më të lartë llogaridhënie.
2. ISP konstatoi se disa prej deputetëve më aktiv në seancat plenare nuk u përfshinë në listat e kandidimit nga partitë e tyre politike ose nuk arritën të sigurojnë mandat tjetër parlamentar. Në kontrast me këtë zhvillim që lidhet me **cilësinë e përfaqësimit**, një numër i madh i deputetëve inaktiv dhe pa gjurmë të aktivitetit parlamentar janë rikandiduar dhe kanë fituar mandat tjetër parlamentar. ISP sugjeron partive politike parlamentare të përcaktojnë rregulla më të qarta vlerësimi për kontributin parlamentar të deputetëve.
3. ISP konstatoi se kjo legjislaturë u dëmtua nga **problemet e inkriminimit** dhe krizat periodike politike. Kuvendi realizoi kalimin e ndryshimeve kushtetuese dhe paketës së reformës në drejtësi, por deri në jetësimin e kësaj reforme, parlamenti ka përgjegjësi të tjera, për të cilat ISP vlerëson se nuk sheh një vullnet politik gjithëpërfshirës, si dhe sugjeron akte të tjera konkrete ligjore në funksion të zbatimit integral të ligjit të dekriminalizimit dhe reformës në drejtësi.
4. ISP vlerëson se legjislatura e mbyllur u dominua nga **retorika politike të personalizuar**. Debatet parlamentare në seanca,

në komisione, në Byro dhe në institucionet e tjera përfaqësuese, dominohen nga retorika e ashpër politike, devijime nga rregullat etike të komunikimit, akuza dhe replikat e personalizuara dhe të motivuara politikisht. Kuvendi ende nuk ka miratuar **Kodin e Etikës**, i cili është në procedurë parlamentare prej fillimit të vitit 2016. Argumenti i nevojës për konsensus politik në miratim është i qëndrueshëm, por Kuvendi ka pasur disa faza konsensuale miratimesh, në të cilat mund të përfshihej edhe Kodi Etik.

5. ISP konstatoi nevojën e madhe që kanë deputetët, sidomos ata me mandate të para parlamentare, për **trajnim profesional me njohuri** mbi Kushtetutën, legjislacionin bazë, Statutin e Deputetit, Rregulloren e Kuvendit dhe akte të tjera të nevojshme për ushtrim cilësor të funksionit të tyre përfaqësues. ISP vlerëson se me prurjet e reja në parlament, kjo nevojë bëhet edhe më e madhe, ndaj nxit Kuvendin dhe Komisionet e Përhershme të programojnë instrumente trajnimi dhe formimi demokratik e ligjor për deputetët dhe stafin mbështetës.
6. Në Kuvend ka pasur raste të vendimmarrjeve që **reflektojnë konflikte interesi** midis deputetëve dhe akteve të amenduara apo votuara prej tyre. Kuvendi duhet të krijojë standarde etike dhe ligjore të atilla, që ta garantojnë procesin ligjvënës nga çdo devijim i mundshëm në konflikte interesi. Për këtë, ISP sugjeron që çdo deputet, përpara se të diskutojë një ligj në komisionet parlamentare, të plotësojë një deklaratë atashuar projektligjit, përmes të cilës deklaron se nuk ka konflikte personale interesi. Në rastin e konfliktit të interesit apo deklarimeve të rreme, kryesia e Kuvendit duhet të informojë seancën plenare dhe të propozojë masa penalizuese për deputetin, sipas të njëjtave standarde që aplikohen për zyrtarët e tjerë të lartë kushtetues në Shqipëri.
7. Kuvendi ka të ligjëruar të drejtën kushtetuese dhe ligjore të secilit deputet për interpelanca parlamentare, seanca pyetjesh, marrje informacioni nga organet ekzekutive, etj, por në praktikë, zbatimi i këtyre të drejtave vijon të jetë **mbi standarde të dyfishta**. Kuvendi duhet të jetë në unison në detyrimin e çdo institucioni për të përmbushur përgjegjësitë e tij ndaj kërkesave për informim të deputetëve, si dhe për rritjen e kontrollit cilësor të tij ndaj pushtetit ekzekutiv.
8. Kuvendi ndjek një traditë tashmë të vjetër të organizimit të punës

së tij, - dy ditët e para të javës punë në komisione parlamentare dhe ditën e enjte seancë plenare. Në seancë diskutohen të gjitha çështjet e mundshme javore, përfshirë tema ditore, diskutime të lira, projekt ligje dhe një numër aktesh të tjera, gjë që krijon zgjatje deri në mesnatë të seancave, mbivlerësim të akteve me rëndësi publike, zhvendosje të prioritetëve të punës dhe dominimin e seancave nga retorika politike. ISP i bashkohet propozimit të mbështetur edhe nga disa drejtues e anëtarë të Komisionit të Ligjeve në Kuvend, për **një strukturë të re të punës së Kuvendit**, - me më shumë seanca ditore në javë, të ndara në problematika: në debate të lira, në shqyrtim e miratim ligjesh dhe në përmbushje të funksioneve të tjera parlamentare, si interpelancat, pyetjet, etj.

9. ISP konstatoi se shumë prej rekomandimeve që vijnë nga Komisionet parlamentare referuara ligjeve, akteve të tjera në Kuvend apo **kontrollit të institucioneve të pavarura**, mbesin në kuadër deklarativ. Kuvendi nuk ka mekanizëm funksional, i cili të ndërlidhë të gjitha propozimet, amendimet dhe rekomandimet ndërmjet komiseve të ndryshme për të njëjtën çështje, dhe më pas, të ndjekë ecurinë e tyre në procesin ligjvënës e ligj-zbatues.
10. ISP konstatoi një distancë të dukshme midis **stafit politik të Kuvendit dhe stafit administrativ**, me dominim të stafit politik. Ky sistem pune, praktikë e disa institucioneve të tjera sidomos atyre ekzekutive, vlerësojmë se nuk duhet të ndiqet në rastin e Kuvendit, i cili përfaqëson institucionin e vetëm përfaqësues të të gjithë vullnetit politik e ligjvënës në vend. Kuvendi duhet të krijojë standarde më të larta në trajtimin ligjor dhe profesionale të stafëve administrative, si dhe të evitojë rolin kontrollues e dominues të stafit politik.
11. ISP vlerëson se **gratë deputete** kanë qenë më aktive sesa burrat deputetë në diskutimet parlamentare dhe shpreh keqardhjen se rreth gjysma e tyre nuk u përfshinë në listat e kandidimit në zgjedhjet e qershorit, dhanë dorëheqje ose nuk arritën të zgjidhen. **Aleanca e Grave Deputete** shënoi një përvojë të parë pozitive në jetën parlamentare. Ajo u dëmtua nga fakti se gjatë periudhës së monitorimit 2017, parlamenti ishte i ndarë politikisht dhe kriza politike solli edhe bojkotin e Kuvendit. Në legjislaturën e re parlamentare Kuvendi duhet të krijojë instrumente mbështetës e funksionale afatgjatë, me mbështetje në ekspertizë, në aspektet buxhetore dhe administrative, për ti dhënë rol më të madh dhe më aktiv grupimit të grave deputete.

- 12.** Kuvendi ka rritur cilësinë e informimit publik dhe **mekanizmat e transparencës parlamentare**, sidomos përmes publikimeve administrative në faqen zyrtare dhe aksesit në rritje për tërheqje informacioni. ISP sugjeron që faqja zyrtare e kuvendit të jetë më e aksesueshme në elementët kryesorë të transparencës, siç janë shpenzimet financiare për deputetët, përfitimet financiare të tyre, shpenzimet financiare të seancave dhe të komisioneve, informacionet mbi delegacionet ndërkombëtare të kuvendit, informacionet mbi mënyrën e realizimit të buxhetit dhe praktikat konkrete të shpenzimeve parlamentare, etj. ISP apelon Kuvendit për vënien në dispozicion të publikut të të dhënave që lidhen me trajtimin financiar dhe përfitimet ligjore financiare të secilit nga anëtarët e Kuvendit. Kjo është kërkesë ligjore, është standard dhe kriter për transparencën publike.
- 13.** ISP sugjeron forcimin e komisioneve parlamentare **përmes ekspertizës së nevojshme**, përmes asistencës ndërkombëtare dhe përmes hapjes me publikun. Komisionet mbeten thelbi i efektivitetit të parlamentit, ndaj Kuvendi duhet të përcaktojë një ndarje më të mirë cilësore të deputetëve në komisione dhe të investohet në rritjen e cilësisë së punës së tyre.
- 14.** ISP ka konstatuar se deputetë apo grupe parlamentare, në funksion të përmirësimit të cilësisë së ligjeve dhe sidomos shkrimit ligjor të tyre, ka kërkuar asistencë të jashtme nga institucione dhe individë të tjerë, kontribute që cilat zyrtarisht nuk njihen dhe as nuk vlerësohen. Kuvendi duhet të krijojë **mekanizma monitorimi, njohje, vlerësimi dhe shpërblimi** për format e ekspertizës së jashtme akademike dhe profesionale që kërkohet nga deputetë dhe grupe parlamentare. Ekspertiza e jashtme e thelluar dhe profesionale rrit cilësinë e ligjeve dhe i bën vendimmarrjet më funksionale, më transparente dhe më përfaqësuese.
- 15. Komisionet hetimore në Kuvend** kanë shërbyer kryesisht për aksione politike e partiake të ditës. Impakti përmirësues në jetën institucionale dhe cilësinë e mirëqeverisjes ka qenë minimal. Sistemi i komisioneve do të duhet të reformohet, në mënyrë që ato të shihen e të trajtohen si mekanizma kushtetues pozitiv, në funksion të interesit publik e rendit kushtetues.
- 16.** Deputetët dhe Kuvendi duhet të zgjerojnë **gamën e mekanizmave dhe instrumenteve mbikëqyrës** ndaj institucioneve të tjera.

Kuvendi, krahas funksionit formal raportues të institucioneve kushtetuese, duhet të punojë shumë më tepër për krijimin e mekanizmave funksionalë për ndjekjen dhe monitorimin e rekomandimeve të Kuvendit dhe institucioneve të pavarura.

- 17.** Kuvendi duhet të rrisë kapacitetet e tij monitoruese për vlerësimin e nivelit të zbatimit dhe të përputhshmërisë me **acquis komunitare**.
- 18.** ISP ka konstatuar problematika në **standardet e publikimeve nga Kuvendi** dhe QBZ të akteve të miratuara në Kuvend. Të tilla janë vonesat në publikime, mungesa në disa raste e publikimeve, publikimet vetëm në elementët e ndërhyrjes në ligj, duke krijuar paqartësi në publikun e interesuar mbi përmbajtjen finale të ligjit, publikime me gabime drejtshkimore, etj. ISP i sugjeron Kuvendit të miratojë standarde të shkruara dhe normative të praktikës së publikimeve online dhe më pas edhe në QBZ, duke ofruar ligjet e plota jo thjesht amendimet e tyre, si dhe duke realizuar botime me cilësi gjuhësore e profesionale të ligjeve dhe akteve.
- 19.** Kuvendi publikon votimet e deputetëve vetëm në rastet e votës elektronike, duke pamundësuar publikut të njihet rregullisht me votën e deputetëve. ISP sugjeron që Kuvendi në çdo rast votimi, përveç votimeve të fshehta, do të **duhet të bëjë publike** votën e secilit deputet, pavarësisht nëse ajo është ushtruar në rrugë elektronike apo me dorë.
- 20.** ISP sugjeron që të gjitha **dokumentet parlamentare** që nuk përbëjnë sekret shtetëror dhe që lidhen me procesin ligjvënës, siç janë ekspertizat e jashtme, raportimet e institucioneve të treta, raportet e vetëvlerësimit të brendshëm etj, duhet të përfshihen në listën e dokumentacionit online në dispozicion të publikut.
- 21.** ISP sugjeron nevojën e krijimit të **buxheti të veçantë parlamentar për botime serioze** mbi parlamentin dhe punimet parlamentare, jashtë detyrimeve dhe praktikës tashme formale të botimit të diskutimeve dhe të procesverbaleve të ndryshme. Publiku i interesuar dhe vetë jeta parlamentare kanë nevojë për botime e studime serioze, për detaje teknike dhe të dhëna profesionale mbi deputetët, për më shumë memorie institucionale dhe reflektim të pritshmërive të larta publike ndaj Kuvendit. Ribotimi i revistës së Kuvendit është një zhvillim pozitiv, por i pamjaftueshëm në këtë drejtim. Institucioni duhet të jetë në gjendje të ofrojë studime të

avancuara dhe profesionale, që lidhen me punën e tij, problematikën, ligjet dhe procesin ligjvënës e ligj-zbatues, krahasimet midis periudhave parlamentare, etj.

METODOLOGJIA

Për realizimin e monitorimit ISP është bazuar në praktikën e njëjta që aplikohen në vende të tjera evropiane, në sistemin e monitorimit të “open parliament” dhe në praktikën e sugjeruara nga rrjeti ndërkombëtar i transparencës parlamentare (IPU).

- ▶ Stafi i ISP ka analizuar Ligjin mbi Statutin e Deputetit, Rregulloren e Kuvendit, si dhe akte të tjera ligjore dhe nën ligjore që rregullojnë aktivitetin e parlamentit dhe të deputetëve. Pjesë e analizës kanë qenë edhe akte të Kuvendit të Shqipërisë në drejtim të transparencës publike, bashkëpunimit me shoqërinë civile, etj.
- ▶ Elementi i dytë i monitorimit lidhet me aktivitetin e Kuvendit si institucion, kryesisht në produktin ligjor dhe politik të tij. Janë monitoruar seancat plenare, mbledhjet e Byrosë dhe të Komisioneve, praktikën e punës, aktet e nxjerra, të propozuara dhe të miratuara, si dhe elementë të tjerë të punës së Kuvendit. Janë analizuar rezolutat e kaluara në Kuvend, raportimet e institucioneve të pavarura, praktikën zgjedhore të aplikuar në parlament, si dhe
- ▶ Elementi i tretë i monitorimit lidhet me aktivitetin e deputetëve, pjesëmarrjen e tyre në seancat plenare dhe në komisione, nismat ligjore të ndërmarra nga deputetët, votimet në kuvend, diskutimet dhe kontributi në komisionet parlamentare. Pjesë e analizës së deputetëve janë edhe të dhëna që lidhen me aktivitetin e tyre politik si parlamentar, lidhjet me zonën zgjedhore, besimin fetar, lëvizjet e deputetëve në parti të ndryshme, prurjet e reja parlamentare, si dhe vlerësimi nëse janë rikandiduar në zgjedhjet e qershorit 2017.
- ▶ Të dhënat e monitorimit janë konsultuar me ekspertë të parlamentit dhe juristë me përvojë në çështjet parlamentare, me drejtues të disa komisioneve në parlament dhe me zyrtarë të administratës. Raporti final do të publikohet në broshurë, në dispozicion të publikut dhe të deputetëve të legjislaturës që sapo u mbyll dhe asaj që e pason në shtator 2017.



Tentojnë të vjedhin
bankomatin në
Sarandë, arresto...



Ristrutturimi, shkëlqim
drejtoritë arsimore,
bashk...



Tre qytetet ku
shqetësimet ekonomike
janë më të larta

Partitë dhe parlamenti - Deputetët më dhe më të "heshtur" gjatë 2017-ës


2/06/2017 - 8:25



Standardi shqiptar i vlerësimit: nga deputetët me aktin për ri-kandidimin nga partitë politike (Alblysa, Topi, Topall, etj.)

Rezultati i votave të zgjedhjes së deputetëve të Kuvendit të Kosovës

Emri i kandidatit	Partia	Votat
Alblysa, Topi, Topall, etj.	Partia Demokratike e Kosovës	10.000
Alblysa, Topi, Topall, etj.	Partia Socialiste e Kosovës	8.000
Alblysa, Topi, Topall, etj.	Partia e Vetëvendosjes	7.000
Alblysa, Topi, Topall, etj.	Partia e Lirisë	6.000
Alblysa, Topi, Topall, etj.	Partia e Bashkuarë	5.000
Alblysa, Topi, Topall, etj.	Partia e Pavarësisë	4.000
Alblysa, Topi, Topall, etj.	Partia e Drejtësisë	3.000
Alblysa, Topi, Topall, etj.	Partia e Mirënjohjes	2.000
Alblysa, Topi, Topall, etj.	Partia e Shpresës	1.000
Alblysa, Topi, Topall, etj.	Partia e Ardhmërisë	0.000

[illegible]

Kuvendi: vetëm 13 ligje. Dominojnë aktet rutinë

Seiten 4 und 5 der parlamentarischen Ratifizierung und die in der zweiten Sitzung der Kommission der Europäischen Union am 20. Juni 2017. Die Kommission der Europäischen Union hat am 20. Juni 2017 die Ratifizierung der Europäischen Union für die Europäische Union als Ganzes bestätigt. Die Kommission der Europäischen Union hat am 20. Juni 2017 die Ratifizierung der Europäischen Union für die Europäische Union als Ganzes bestätigt. Die Kommission der Europäischen Union hat am 20. Juni 2017 die Ratifizierung der Europäischen Union für die Europäische Union als Ganzes bestätigt.

[illegible]

KRYESORE **POLITIKË** **AKTUALITET** **EKONOMI** **KULTURË & ART** **FCB-BOMB**

DEPUTETËT MË AKTIV DHE MË "TË HESHTIUR"
NË 2017-ËN

Publikuar tek Aktualitet Diel, 11 June 2017 19:30

2017 19:39

Komento i pari!

DEPUTETËT MË MË SHUMË DISKUTIME PARLAMENTARE 2017

DEPUTETËT	DISKUTIME	DEPUTETËT	DISKUTIME
Ben Blushi		Silva Caka	
Mimoza Hafizi	15	Mesila Doda	5
Laudan Balla	10	Adelina Rista	5
Ervin Bushati	9	Andrea Marto	4
Erion Brace	8	Anila Agalliu	4
Loli Rama	7	Besnik Baraj	4
Kristina Althya	7	Edmond Leka	4
Sali Berisha	6	Eduard Shali	4
Fatmir Toçi	6	Jozefina Topalli	4
Gramoz Ruci	6	Naim Kopliku	4
Antonella Dholia	6	Pjerin Ndres	4
Vasilisa Hyri	6	Xhemal Gaxhalla	4
SORINA INSTITUTI SHQIPTARË POLITIKE	6	MONITORINGU	

Standardi shqiptar i vlerësimit: nga 1 u përshinë në listat e shqiptarëve

Topalli, Kopliku

Komento i paril

Standardi shqiptar i vlerësimit: nga 1 deri në 5
u përfshinë në listat e riutësimit të Topalli, Konjicës dhe...

	MEYUNJANNE	ORTODOOKSE	KATOLIKE
ERU	86%	14%	0%
ERAT	100%	0%	14%
DUBRE	79%	7%	8%
DUBRE	71%	21%	0%
ERASAN	69%	11%	0%
ER	80%	36%	23%
ERKONKASTIR	64%	0%	100%
KONK	67%	0%	45%
KUKES	0%	0%	3%
LEZVE	55%	12%	0%
SHKODER	85%	33%	0%
THANE	67%	18%	12%
VLORE	71%	18%	9%
TOTAL 140	74%	5%	16%
PS	72%	26%	11%
	83%		





KUVENDI I SHQIPËRISË, MONITORIMI DHE TREGUESIT KRYESORË

Në sistemin tonë politik e qeverisës institucioni i Kuvendit përbën institucionin kryesor vendimmarrës, ushtrues të sovranitetit dhe garant për ushtrimin e qeverisjes mbi bazën e parimeve të ndarjes e balancës së pushteteve. Nga parlamenti buron qeveria, Presidenti, institucionet më të rëndësishme të gjyqësorit dhe prokurorisë, të sigurisë dhe mbrojtjes, të kontrollit financiar shtetëror dhe ekonomisë, të botës akademike dhe pushteti vendor apo Avokati i Popullit.

- ▶ Për shkak të kësaj rëndësie është në interes të shumëfishtë publik ekzistenca e një institucioni parlamentar transparent dhe funksional, përfaqësues dhe vendimmarrës. Qytetarët kanë pritshmëri të larta tek parlamenti, pjesëmarrja e lartë në zgjedhjet parlamentare 2013 e reflektoi këtë pritshmëri, ndërkohë që aktiviteti dhe debatet parlamentare vijnë të jenë tema më e diskutuar publike, mediatike dhe shoqërore.
- ▶ Monitorimi i Kuvendit dhe sidomos i aktivitetit të deputetëve, përbën edhe një prej aspekteve të punës në drejtim të rritjes së besimit publik tek institucionet përfaqësuese, rritjen e transparencës publike dhe nevojën për më shumë përgjegjësi përballë qytetarëve nga të zgjedhurit në poste të larta politike. Në sondazhet vjetore Kuvendi dhe deputetët marrin vlerësime minimale pozitive në raport me një sërë institucioneve të tjera përfaqësuese, dhe krahas partive politike dhe sistemit të drejtësisë konsiderohen gjërësisht si institucionet më pak të besueshme dhe më pak përfaqësuese.
- ▶ Në Shqipëri ekzistojnë një numër i konsiderueshëm organizatash të shoqërisë civile, disa prej të cilave veprojnë në fushën e monitorimit të institucioneve demokratike, por asnjë prej tyre nuk ka pasur fokus monitorimin parlamentar gjatë viteve 2013-2015. Më 2016 Instituti i Studimeve Politike kreu monitorimin e parlamentit në aspektet e organizimit parlamentar, punës së parlamentit, nivelit të angazhimit të deputetëve dhe tregues të tjerë kryesisht politik të aktivitetit të Kuvendit. Gjetjet e ISP u mirëpritën nga media, komuniteti i ekspertëve dhe një pjesë aktive e deputetëve.
- ▶ Gjatë vitit 2017 FES ka dhënë mbështetje për realizimin e monitorimit parlamentar deri në fundin e këtij sesi, kurse nga shtatori 2017 deri shtatori 2020 ISP do të realizojë monitorimin e detajuar dhe cilësor të parlamentit dhe secilit prej deputetëve, - duke krijuar edhe një sistem informimi publik shumë më transparent dhe të referueshëm. Projekti i ri përfshin krijimin e një aplikacioni online mbi deputetët

dhe aktivitetin e tyre, me qëllim që çdo qytetar i interesuar të marrë në cdo kohë informacionet e duhura mbi aktivitetin e deputetit që e përfaqëson, si dhe aktivitetin e institucionit të Kuvendit.

3.1. RAPORT PROGRESI 2016 DHE MBI BILANCI I KUVENDIT 2017

Në nëntor 2017 nuk do të ketë progres raport të KE mbi Shqipërinë, sipas praktikës së ndjekur prej më shumë se një dekade. Raporti i fundit i progresit të Komisionit Evropian u publikua në nëntor 2016. Pjesë e tij ishte edhe vlerësimi për rolin dhe aktivitetin e Kuvendit të Shqipërisë.

- ▶ Referuar këtij raporti¹, me të drejtë theksohet se gjatë viteve të fundit “janë përmirësuar kontaktet me zgjedhësit dhe transparencja e gjithë përfshirja e aktiviteteve parlamentare”. Ai vlerëson faktin se transparencja dhe gjithë përfshirja në punën e parlamentit vazhdon të ndjekë trendin rritës. Faqja e re e parlamentit ka përmirësuar ndjeshëm qasjen në dokumentet e parlamentit” si dhe sugjerimin për më shumë transparencë në nivel komisioni.
- ▶ Në shkurt u rritën kapacitetet e ekspertëve dhe u miratua rritja e alokimeve buxhetore për trajnime, por kapacitetet kërkimore dhe analitike mbetën të kufizuara.
- ▶ Më tej, në raport thuhet se “etika parlamentare nuk i përmbush dispozitat rregullatore dhe pritshmëritë e publikut. Pritet të miratohet kodi i etikës, i cili ka qenë në procedurë parlamentare që nga fillimi i vitit 2016”. Pas përfundimit të legjislaturës parlamentare 2013-2017 Kodi i Etikës nuk është miratuar ende dhe pritet të jetë pjesë e axhendës parlamentare në vjeshtën e vitit 2017.
- ▶ Në progres raportin e KE (2016) theksohej gjithashtu se “vazhdon puna ndër-partiake për reformat kyçe, megjithëse dialogu politik është polarizuar në disa raste” dhe se “nga të gjitha ligjet e miratuara gjatë periudhës së raportimit, rreth një e treta ka marrë mbështetjen e opozitës (për periudhën e mëparshme të raportimit, vetëm 16 nga

1. - Raporti i vitit 2016 për Shqipërinë DPS (2016) 364, Bruksel, 9.11.2016.

173 ligje siguruan mbështetje ndër-partiake)”. E njëjta problematikë u vijua edhe gjatë vitit 2017, përfshirë krizën politike të pranverës shoqëruar me bojkotimin parlamentar nga ana e opozitës.

- ▶ Lidhur me rolin dhe aktivitetin e Kuvendit progres raporti 2016 nënvizonte se “ligji për rolin e Kuvendit në procesin e integritetit në BE, të miratuar në mars të vitit 2015 duhet të reflektohet në rregulloren parlamentare” dhe se “kapaciteti i përgjithshëm i Kuvendit për të monitoruar zbatimin dhe përputhshmërinë e ligjit të ri me *acquis*-in mbetet i kufizuar. Përveç disa përpjekjeve, nevojitet koordinimi mëtejshëm me degët ekzekutive”. E njëjta situatë vijon edhe gjatë vitit 2017.
- ▶ Lidhur me komisionet hetimore progres raporti vlerëson se “puna e komisioneve hetimore mbetet tepër konfliktuale dhe nuk solli rezultate. Mekanizmat e tjerë mbikëqyrës mbetën më pak të shfrytëzuara. Parlamenti zhvilloi një proces rishikimi më të strukturuar të raporteve vjetore mbi institucionet e pavarura dhe miratoi 16 rezoluta. Gjithsesi, duhet të zhvillohet një sistem gjithëpërfshirës për ndjekjen dhe monitorimin e rekomandimeve të Kuvendit dhe institucioneve të pavarura”. Përcaktimet janë të saktë dhe vijnë të jenë të pa ezauruara nga ana e Kuvendit edhe gjatë vitit 2017.

3.2. PROBLEMATIKA QE LIDHEN ME PËRBËRJEN DHE PËRFAQËSIMIN

Institucioni i Kuvendit në Shqipëri është një prej institucioneve më të rëndësishme kushtetuese, dhe krahas përcaktimeve kushtetuese e rregullon aktivitetin e tij përmes legjislacionit organik, - ligjin 8500 mbi statusin e deputetit (1999) dhe Rregulloren e Kuvendit në RSH (datë 16.12.2004) të ndryshuar në dhjetor 2005, në korrik 2008, në mars 2010, në qershor 2010, në shkurt 2011, maj 2013 dhe nëntor 2014.




- ▶ Parlamenti i periudhës nën monitorim (janar – qershor 2017) është zgjedhur në qershor 2013 dhe ka mandat deri në shtator 2017. Ashtu si parlamentet e viteve 1992, 1997, 2005 edhe ai i vitit 2013 përfaqësojnë mazhoranca solide të mandateve të para qeverisëse.

Mazhoranca në parlament bazohet në koalicionin politik midis dy prej tri partive më të mëdha në vend, Partia Socialiste (PS) dhe Lëvizja Socialiste për Integrim (LSI). Marrëveshja politike e prillit 2013 vijoi në fuqi deri në fund të legjislaturës, dhe bashkëveprimi i tyre ka krijuar një koalicion dominues prej 84-86 vota parlamentare. Pjesë e koalicionit është edhe PDIU, parti e cila më 2013 ishte pjesë e koalicionit të djathtë zgjedhës në zgjedhje, ashtu edhe parti të tjera më të vogla, përfshirë G99, PSV91, PSD, PDS, etj.

- ▶ Kuvendi ka një faqe internet aktive (www.parlament.al), publikon rendin e ditës, axhendat javore dhe mujore, aktet e propozuara ligjore me dokumentacionin mbështetës, votën e deputetëve, procesverbalet e punës në komisione dhe në seancat plenare, aktivitetin kryesor parlamentar, etj. Institucioni drejtues i Kuvendit është kryetari i Kuvendit, i ndihmuar nga tre nënkryetarë (dy nga partitë e mazhorancës PS e PDIU dhe një nga opozita kryesore parlamentare, PD). Më tej parlamenti ka 8 komisione të përhershme, disa komisione të posaçme si dhe njëherësh disa komisione hetimore. Kuvendi ka Byronë e Kuvendit, sekretariatit, grupet parlamentare dhe një administratë të gjerë mbështetëse.
- ▶ Kuvendi boton një revistë parlamentare periodike, publikon rregullisht transkriptin e seancave plenare, zhvillon aktivitete të shumta që lidhen me rolin e parlamentit në qeverisjen e vendit, historinë, rolin në procesin integruar, etj, si dhe ka marrëveshje bashkëpunimi e shkëmbime me disa parlamente në rajon dhe në Evropë. Aktualisht në Kuvend po aplikohet një projekt bashkëpunimi me institucionet partnere në Itali e Greqi, në kuadër të procesit të integritetit.

3.3. PËRBËRJA POLITIKE E KUVENDIT: AKTORË TË VJETËR DHE TË RINJ

Referuar zgjedhjeve parlamentare 2013 koalicioni “Aleanca për Shqipërinë Evropiane” fitoi 83 mandate, përkatësisht: PS 65 mandate, LSI 16 mandate, PBDNJ 1 mandat, PKD 1 mandat. Nga ana tjetër koalicioni opozitar “Aleanca për Punësim, Mirëqenie dhe Integrim” fitoi 57 mandate, nga të cilat PD 50 mandate, PR 3 mandate dhe PDIU 4 mandate. Pas katër vitesh



PD
50

PDIU
4

PR
3

PKDSH
1

PBDNJ
1

LSI
16

PS
65

përbërja parlamentare ka ndryshuar në raportet mazhorancë – opozitë dhe në raportet midis partive politike. Konkretisht, më 30 maj 2017 PS ka 61 deputetë, PD 43, LSI 21, PDIU 5 deputetë, LIBRA 2 deputetë dhe me nga 1 deputet janë PR, LZHK, PDK, PBDNJ, PKD, PAA, PBDK, si dhe 1 deputet është pa përcaktim politik.

- ▶ Në total mazhoranca në periudhën e fundit parlamentare kishte rreth 84-88 deputetë, - shumë më tepër sesa rezultati zgjedhor i vitit 2013. Ndryshimi kryesor lidhet me kalimin e tre deputetëve të opozitës tek LSI, dhe kalimin e PDIU nga opozita në koalicionin qeverisës. Kalimi i partive dhe sidomos i deputetëve nga opozita në mazhorancë mbetet një prej tipareve edhe të kësaj legjislature dhe një prej problematikave që lidhen me cilësinë dhe përgjegjësinë e përfaqësimit politik në vend.
- ▶ Ekzistenca e disa partive të vogla lidhet me mandatet parlamentare të siguruara përmes vendeve të sigurta në listat shumë-emërore të PD (PR, PDK, LZHK) ose përmes votave taktike të fituara brenda koalicioneve politike (PAA, PBDNJ, PKD), ku PAA bën dallimin se është një parti jo-parlamentare por me mandat të “fituar” nga lëvizjet politike paraelektorale më 2016-2017. Disa prej këtyre partive kanë konfirmuar përfaqësimin indirekt në parlament, përsëri duke shfrytëzuar listat shumëemërore të partive të mëdha. Numri formal i lartë i partive në parlament (5-8) është në kontrast me numrin e partive relevante (3 parti), si dhe ishte një prej temave të diskutuara në bisedimet për marrëveshjen politike të 17-18 majit 2017 midis kryeministrit dhe kryetarit të opozitës.

3.4. MIDIS 2013 DHE 2017 JANË “NDRYSHUAR” 30% E PËRBËRJES SË KUVENDIT

Gjatë legjislaturës aktuale janë “ndryshuar” një e treta e deputetëve ose 42 nga 140 deputetë, jo si raport numerik në parlament, por si kandidatë fitues që kanë fituar mandatin ose e kanë humbur atë për arsye politike, procedurale, ligjore ose dorëheqje. Në dallim nga sistemet e mëparshme mazhoritare ose mikse, ku zëvendësimi realizohej përmes votimeve të parakohshme në zonën zgjedhore, në sistemin proporcional zëvendësimi bëhet nga lista shumëemërore, duke u kushtëzuar nga kriteret gjinore.

- ▶ Në total një deputet ka humbur jetën në aksident, rreth 14-15 deputetë kanë fituar mandate për shkak të praktikës së re të mazhorancës për ndarjen e mandateve deputet-ministër, tetë deputetë dhanë dorëheqje më 2015 duke kandiduar për kryetar bashkie në zgjedhjet lokale, një deputet tjetër pasoi këtë praktikë më 2016 në zgjedhjet Dibër, një deputet humbi mandatin nga Gjykata Kushtetuese, një deputete dha dorëheqjen për shkak të një ngjarje familjare, tre deputetë kanë dhënë dorëheqjen në kuadër të ligjit të de-kriminalizimit, dy të tjerë kanë humbur mandatet për shkak të së njëjtit ligj, si dhe të paktën 6 kandidatë fitues kanë dhënë dorëheqjen nën presion për t'ia kaluar mandatin emrit pasues në qarkun Lezhë dhe Durrës.
- ▶ Ndryshimet e vazhdueshme ndodhën edhe në përbërje të grupeve parlamentare (PS, PD dhe LSI në faza të ndryshme i “dhuruan” deputetë për të krijuar grupe parlamentare PR dhe PDIU, të cilat vijojnë të kenë grupe parlamentare prej 7 deputetësh edhe pse më 2017 PR nuk ka zyrtarisht asnjë deputet të zgjedhur në siglën e saj më 2013, kurse PDIU ka 3 deputetë të tillë. Praktika e grupeve fiktive parlamentare mbetet një problematikë dhe objekt për trajtim ligjor gjatë rishikimit të Rregullores së Kuvendit.
- ▶ PD dhe PDIU kanë “shkëmbyer” midis tyre nga një deputet, LSI ka humbur një deputet, por ka marrë deputetë të tjerë nga PD dhe PR, kurse PBDNJ e nisi legjislaturën në mazhorancë duke pasur postin e zv/kryetarit të Kuvendit dhe e mbylli në opozitë dhe dorëheqje nga ky post. Nga mazhoranca janë shkëputur tre deputetë për të krijuar parti të reja politike, dy duke krijuar partinë LIBRA dhe një deputet u bë kryetar i PBDK. Nga dhjetori 2016 tre deputetë e humbën mandatin me vendim të KQZ në kuadër të de-kriminalizimit, dy deputetë dhanë dorëheqje nga mandati (një në kuadër të procesit të de-kriminalizimit dhe një për tu zgjedhur në post tjetër të rëndësishëm), si dhe një deputet ndërroi jetë për arsye shëndetësore. Gjatë 2017 një deputet (kryetari i Kuvendit) u zgjodh President i Republikës.
- ▶ Më 30 mars 2017, rreth 40 ditë përpara përfundimit të legjislaturës parlamentare u betuan edhe dy deputetët e rinj, Petrit Gjoni (LSI) dhe Xhavit Bushaj (PS). Rasti “Gjoni” mbetet unik në përvojën parlamentare shqiptare, pasi PS konsumoi tërësisht listën e saj proporcionale në Lezhë dhe për pasojë, mandati i lirë i saj, në përputhje me Kodin Zgjedhor, i kaloi partisë së dytë aleate më të votuar, LSI.

- Për shkak se mandati parlamentar i legjislaturës aktuale vijon deri në shtator 2017 Kuvendi njoftoi KQZ për vakancën dhe KQZ ia kaloi mandatin emrit pasues në listën shumë-emërore të PD 2013 në qarkun Lezhë. Bazuar në njoftimet e KQZ kandidati vijues në listë e refuzoi mandatin, duke ia kaluar atë automatikisht kandidatit vijues. Gjithashtu pati një rast tjetër të dorëheqjes së deputetit Çuko (PS) dhe kalimit të mandatit të tij tek kandidati vijues në listën e qarkut Fier A.Çabani. Procedura të tilla janë korrekte në raport me ligjin, por de facto nuk kanë sens në aspektin politik e përfaqësues, pasi parlamenti nuk është më funksional dhe cilido të marrë mandatin, ai nuk do të mund ta ushtronte funksionin e tij.

3.5. PËRBËRJA PARLAMENTARE BAZUAR NË BESIMIN FETAR

Në kuadër të transparencës publike dhe për arsye edhe studimore, ISP realizoi për herë të parë edhe analizën e të dhënave të deputetëve mbi besimin e tyre fetar. Mbështetur në të dhëna zyrtare dhe në verifikime konkrete në kontakte me stafet e deputetëve të caktuar, u arrit në evidentimin e të dhënave që jepen në tabelën bashkëngjitur.

- Sipas tabelës bashkëngjitur, tri partitë e mëdha kanë përfaqësim të njëjtë të shumicës fetare në vend, dy partitë kryesore PS e PD kanë përfaqësim të njëjtë edhe në dy besimet e tjera fetare. PDIU ka një përfaqësim të disbalancuar, ashtu si edhe tradita e PBDNJ, ndërkohë që njëra nga partitë me emërtim të qartë fetar përfaqësohet në parlament me një deputet të besimit tjetër fetar.
- Referuar drejtuesve të kuvendit dhe të komisioneve parlamentare, përbërja e tyre dominohet nga i njëjti besim fetar, - një tregues se partitë nuk ndjekin cilësi të besimit fetar në përzgjedhjen e kandidatëve për poste drejtuese në parlament.
- Gjatë viteve 2014-2017 ka pasur një debat të gjatë mbi cilësinë e përfaqësimit të disa deputetëve të së njëjtit besim fetar nga qarqet Shkodër e Lezhë, ku pala mbështetëse e tyre ka mbrojtur tezën se ata përfaqësojnë nivelin kulturor e politik të zonës. Teza e tyre është kontestuar gjerësisht duke krijuar shqetësime nëse përzgjedhja nën

Partia parlam-entare	Deputetë besimi mysliman	Në % e grupit	Deputetë besimi ortodoks	Në % e grupit	Deputetë besimi katolik	Në % e grupit
PS	47	75%	9	14%	7	11%
PD	32	74%	6	14%	5	12%
LSI	15	75%	4	20%	1	5%
PDIU	5	100%	-	0%	-	0%
LIBRA	1	50%	1	50%	-	0%
PR	1	100%	-	0%	-	0%
LZHK	1	100%	-	0%	-	0%
PDK	-	0%	-	0%	1	100%
PAA	1	100%	-	0%	-	0%
PBDNJ	-	0%	1	100%	-	0%
PKD	1	100%	-	0%	-	0%
Pa parti	-	0%	-	0%	1	100%


Burimi: Instituti i Studimeve Politike: www.isp.com.al - Monitorimi i parlamentit 2017

standardet e duhura të kandidatëve të zona të ndryshme, si dy zonat në fjalë, dëmtojnë vetëm partinë politike respektive, parlamentin apo edhe raportet e përfaqësimit mbi bazën e përbërjes fetare të popullsisë.

3.6. VITI 2017, - REKORD I NUMRIT TË GRAVE DEPUTETE DHE MINISTRE

Pas aplikimit simbolik të sistemit të kuotave gjinore në kandidim (2009) dhe më pas me elementë në drejtim të kuotës në zgjedhje (2013) është rritur tendencën e përfaqësimit gjinor përgjatë tranzicionit në Shqipëri. Një faktor ndikues në përfaqësimin gjinor, përveçse vullneti politik dhe

NUMRI I GRAVE MINISTRE 1991 - 2017



Burimi: Instituti i Studimeve Politike: www.isp.com.al

niveli demokratik shoqëror dhe i partive politike, mbetet edhe vetë sistemi zgjedhor.

- ▶ Në sistemin mazhoritar (1991) vetëm 4% e parlamentit përbëhej nga gra e vajza. Me sistemet mikse të votimit (1992-2005) pati rritje të vogël të përfaqësimit gjinor, midis 5.7 deri 15%.
- ▶ Kuota më e lartë u shënua në zgjedhjet e vitit 1996, të cilat janë një prej dy zgjedhjeve më të kontestuara të kësaj periudhe.
- ▶ Me kalimin në sistemin proporcional rajonal (2008) zgjedhjet pasuese 2009 sollën rritje të numrit të grave në parlament dhe përqindjes së tyre në raport me gjininë tjetër. Ky trend u ruajt edhe më 2013 kur kishim 25 gra deputete ose 18%, ndërkohë që për shkak të ndryshimeve në listat shumë-emërore të deputetëve aktualisht (2017) kemi 33 deputete ose 23.5% të përbërjes së parlamentit, - shifra më e lartë e tranzicionit.

- I njëjti trend përfaqësimi gjinor është reflektuar edhe në postet ekzekutive, të votuara në parlament. Konkreisht, më 1991-1995 nuk kishim asnjë ministere grua, më 1995 vetëm 1 ministere, më 1996 katër ministere gra, gjatë 1997-2005 kishim 2 ose 3 gra ministere, midis 2005-2013 vetëm një deri në dy gra ministere, më 2013 mazhoranca e majtë emëroi 6 gra ministere, dhe pas ndryshimeve në qeveri gjatë viteve 2013-2017 në mars 2017 kishim 10 gra ministere. Me ndryshimet në qeveri në maj 2017 numri i grave në qeveri u shtuan edhe me një portofol më shumë, - shifra më e lartë në historinë politike të Shqipërisë.

3.7. DY TË TRETAT E DEPUTETËVE JANË BANORË TË PËRHERSHËM NË TIRANË

Legjislacioni mbi Kuvendin nuk ka kritere detyruese që lidhin deputetin me vendbanimin e tij, megjithatë vazhdimisht ka pasur shqetësime rreth tendencës së politika është përqendruar në Tiranë dhe qytetet periferike janë të papërfaqësuar sa duhet. ISP kreu për herë të parë në historinë e parlamentit pluralist një monitorim të gjendjes faktike të vendbanimit të deputetëve krahasuar me zonën e tyre zgjedhore.

- Të dhënat monitoruese të ISP mbi vendbanimin e deputetëve (deklarim i detyruar i përcaktuar të ndodhë çdo muaj shtator nga rregullorja parlamentar) tregojnë se në mars 2017 rreth 66% e deputetëve (92 nga 140 deputetë) banojnë në Tiranë. Pjesa tjetër, rreth 27% janë banorë të qyteteve ngjitur me Tiranën (Durrës, Elbasan, Lezhë, Lushnjë) dhe vetëm një pakicë e vogël deputetësh vijon të jetë banor në njësi administrative të periferisë prej të cilave janë zgjedhur. Një raport i tillë krijon problematika të përfaqësimit të zonave zgjedhore dhe lehtëson praktikën kritike të ndjekur nga partitë politike për lëvizje të deputetëve drejt qarqeve të tjera pothuajse në çdo proces zgjedhor.
- Rreth dy muaj përpara fushatës, partitë kryesore politike (PS, PD e LSI) caktuan koordinatorët e bashkive dhe qarqeve, duke bërë zhvendosje të dukshme nga zonat zgjedhore ku të njëjtët individë janë zgjedhur më 2013. Për shembull, tre drejtuesit e listës zgjedhore të qarkut Lezhë për secilën parti kryesore, tashmë janë caktuar

Qarku - Zona elektorale	Ku janë zgjedhur	Ku banojnë	Në % në total	Banues në Qark në %	Diferenca banim- zonë
Tiranë	32	92	65,7%	288%	+ 188%
Durrës	13	8	5,7%	62%	- 38%
Lezhë	7	4	2,8%	57%	- 43%
Elbasan	14	7	5%	50%	- 50%
Fier	16	8	5,7%	50%	- 50%
Korcë	12	5	4%	42%	- 58%
Vlorë	12	5	4%	42%	- 58%
Gjirokastrë	5	2	1,4%	40%	- 60%
Berat	8	3	2,1%	38%	- 62%
Shkodër	11	4	2,8%	36%	- 64%
Dibër	6	2	1,4%	33%	- 66%
Kukës	4	0	0%	0%	- 100%

Burimi: Instituti i Studimeve Politike: www.isp.com.al - Monitorimi i parlamentit 2017

drejtues elektorale dhe kandidatë potencialë në qarqe të tjera. Elementë të njëjtë gjejmë me qarkun e Kukësit, me qarkun e Dibrës, të Beratit, të Durrësit, të Gjirokastrës, etj.

- Disniveli midis numrit të deputetëve në zonë dhe atyre që janë zhvendosur nga zonat zgjedhore drejt qendrës, pasqyrohet edhe në problematikën që vetë deputetët ngrenë në diskutimet e tyre parlamentare. Më shumë se 92% e diskutimeve nuk lidhen me zonën zgjedhore, por me politikën qendrore. Për pasojë, zgjedhësit përmes medias dhe instrumenteve të tjera të komunikimit publik shprehin vazhdimisht shqetësimin në rritje për mungesën e një përfaqësimi direkt të problemeve të tyre në punimet parlamentare.

3.8. PARLAMENTI 2017 DHE NDRYSHIMET NË QEVERI

Gjatë vitit 2017 Këshilli i Ministrave ndryshoi disa herë përbërjen e tij, kryesisht për shkak të problemeve në funksion, si dhe së fundi, për shkak të marrëveshjes politike midis mazhorancës dhe opozitës.

- ▶ Konkretisht, gjatë 2017 fillimisht më 2 shkurt u shkarkua Ministri i Drejtësisë (Manjani), më pas, me 23 mars në Kuvend u shkarkuan Ministri i Brendshëm (Tahiri), i Shëndetësisë (Beqja), i Mirëqenies Sociale dhe Rinisë (Klosi), si dhe Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore (Çuçi).
- ▶ Pas paktit politik PS-PD më 22 maj Kuvendi shkarkoi zv/kryeministrin (Peleshi), Ministrin e Drejtësisë (Vasili), Ministrin e Brendshëm (Xhafaj), Ministren e Arsimit dhe Sportit (Nikolla), Ministren e Shëndetësisë (Manastirliu), Ministren e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë (Xhaçka) dhe Ministrin e Financave (Ahmetaj).
- ▶ Vlen të theksohet se brenda një muaji u ndryshuan nga dy herë titullarët në Ministrinë e Brendshme, në Ministrinë e Drejtësisë dhe në Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, - një tregues brishtësie i funksionimit të jetës parlamentare dhe politike në Shqipëri. Në secilin rast ndryshimet nuk erdhën për shkak të presionit ose procesit parlamentar, por për shkak të zhvillimeve politike jashtë parlamentit.
- ▶ Pas zgjedhjeve të qershorit ishte paralajmëruar ndryshime të reja në qeveri, - largim i ministrave teknikë të propozuar nga opozita, ose edhe largim të mundshëm nga qeveria e LSI, parti e cila tashmë ka kaluar në opozitë. Deri në mbylljen e këtij raporti nuk ndodhi asnjëra nga ndryshimet, kryesisht për shkak të kushtëzimit të ndryshimeve në qeveri me nevojën për dekretim nga Presidenti dhe thirrjen e një seance tjetër të jashtëzakonshme të Kuvendit për votimin e dekreteve. Për më tepër, në një rast të tillë hipotetik do të duhet të vlerësohet përputhshmëria e akteve të Kuvendit me Kushtetutën, pasi neni 65 i Kushtetutës, përcakton se *“Kuvendi nuk mund të nxjerrë ligje gjatë periudhës 60 ditë para mbarimit të mandatit të tij deri në mbledhjen e parë të Kuvendit të ri, me përjashtim të rasteve të vendosjes së masave të jashtëzakonshme”*.



PROBLEMATIKA POLITIKE DHE ADMINISTRATIVE E KUVENDIT

4

ISP ka ndjekur problematikat e zbatimit të Rregullores në funksionimin e Kuvendit, si dhe problematike specifike që lidhen me Statutin e Deputetit. Këto dy dokumente kryesore të punës në Kuvend janë miratuar prej vitesh dhe në disa elementë paraqesin dokumente të tejkaluara nga koha. Nevoja për ndërhyrje përmirësuese mbetet çështje për trajtim në të ardhmen, por ndërkohë, në formën e tanishme dhe të sugjeruar, në cdo rast, merr rëndësi zbatimi integral i normave të shkruara, përfshirë detyrimet që burojnë nga Rregullorja dhe Statuti i Deputetëve.

Situata politike në prag të zgjedhjeve parlamentare 2017 pësoi ndryshime të rëndësishme kur me 18 shkurt 2017, pas një proteste në Tiranë, opozita deklaroi bojkotimin e parlamentin duke kontestuar qeverinë e mazhorancën. Opozita mori më pas një aksion politik 90 ditë të protestës dhe refuzoi rikthimin në parlament, duke kërkuar standarde më të larta zgjedhore, garanci më të mëdha për zgjedhjet 2017 dhe sidomos, dorëheqjen e kryeministrit Rama.

- ▶ Në mesin e muajit maj, partitë kryesore parlamentare nisën dialogun politik dhe më 18 maj kryetarët e dy partive kryesore lajmëruan arritjen e një marrëveshjeje politike. Deri në momentet e hartimit të këtij raporti nuk ka ende një dokument zyrtar dhe publik të firmosur të marrëveshjes, por ka citime dhe referime ndaj saj, nga të gjitha institucionet, përfshirë Kuvendi apo KQZ. Për rrjedhojë të marrëveshjes, u mbajt seanca e jashtëzakonshme e datës 22 maj, ku morën zgjidhje problematikat kryesore që lidheshin me zgjedhjet, qeverinë dhe procesin e vetingut.
- ▶ Në historinë e pluralizmit në Shqipëri parlamenti është bojkotuar disa herë nga opozitat politike (1993, 1994, 1996, 1997, 2001, 2007, 2009, 2014 dhe së fundi edhe më 2017). Për herë të parë bojkoti parlamentar është bërë në prag të fushatës për zgjedhjet e reja parlamentare. Gjithashtu për herë të parë protesta e rregullt opozitare zgjati rreth 3 muaj, më gjatë se çdo protestë tjetër sistematike, duke çuar edhe vendin në prag të një krize të thellë politike dhe institucionale.
- ▶ Vendimet më të rëndësishme të parlamentit aktual do të duhej të ishin ato lidhur me reformën në drejtësi (ligji i vetingut dhe një paketë ligjesh të tjera plotësuese), ndaj bojkoti fillimisht pamundësoi konsensusin rreth trupës parlamentare konsensuale që do duhet të nisë praktikën e vetingut, - si hapi thelbësor për jetësimin e reformës në drejtësi.

- Po ashtu, të dhënat krahasimore të punës së komisioneve parlamentare tregojnë se bojkoti politik i parlamentit ka krijuar vështirësi të funksionimit të komisioneve dhe aktivitetin normal të parlamentit. Mazhoranca përdori praktikën e angazhimit intensiv të anëtarëve zëvendësues në komisione në mënyrë që të arrihej kuorumi i nevojshëm për funksionimin e tyre. Shumë prej deputetëve zëvendësues nuk kishin formim në përputhje me komisionin ku u dërguan për shkak të kuorumit, ndaj pothuajse të gjithë ata nuk u përshinë në debatet dhe diskutimet e punës në komision. Në total, rreth 8 mbledhje komisionesh u shtyrë për shkak të mungesës së kuorumit të nevojshëm për zhvillimin e tyre.

4.1. MUNGESA E OPOZITËS: INJORIM TË STANDARDIT MBI TRANSPARENCËN

Duke iu referuar periudhës përpara datës 20 shkurt dhe zhvillimeve më pas konstatohet se bojkoti parlamentar i opozitës është shoqëruar me rënie të ndjeshme të vëmendjes së mazhorancës për respektimin e praktikave dhe standardeve rigoroze të transparencës dhe të rregullores së Kuvendit.

- Për shembull, vendimi i Kuvendit për shtyrjen edhe një muaj të afatit të punës për Komisionin e Reformës Zgjedhore (séanca e datës 9 mars 2017), nuk është publikuar në faqen zyrtare të Kuvendit në momentin e verifikimit në fazën e parë të monitorimit, datë 31 mars 2017. Kuvendi raportoi se më pas dokumenti është botuar. Gjithashtu stafi monitorues evidentoi nuk janë publikuar relacioni, propozimi, votimi dhe të dhëna të tjera të rëndësishme që lidhen me këtë akt.
- Duke monitoruar të dhënat e publikuara në faqen zyrtare të Kuvendit, konstatohet se, p.sh, në verifikimin e gjendjes me datën 30 mars 2017, të dhënat mbi mënyrën sesi kanë votuar deputetët nuk ishin publikuar për asnjë nga votimet e ndodhura gjatë muajit mars 2017. Edhe një sërë elementësh të tjerë teknikë, që lidhen me punën e komisioneve, korrektesën në publikimin e procesverbaleve, etj, nuk u publikuan brenda afatit të caktuar, në të njëjtën periudhë kohore, kur edhe opozita nuk është e pranishme në Kuvend.
- Kuvendi pati vonesa në publikimin e rendit të ditës dhe elementëve të tjerë informues mbi punimet e parlamentit, si dhe aktet e

publikuara pas miratimit ishin relativisht të paplota, pa relacion shoqërues apo pa sqarimet e duhura mbi autorët e nismës dhe ndryshimet e ndodhura në seancë në draftin e kaluar në Kuvend. Lidhur me vonesat në publikimin e procesverbaleve të komisioneve parlamentare, Kuvendi e arsyeton me të drejtë atë me shpeshtësinë e mbledhjeve, personelin në dispozicion dhe kohën që kërkon një proces i tillë.

- Gjatë periudhës së bojkotit të opozitës edhe vetë aktiviteti parlamentar kaloi në rutinë, në disa raste u bë presion nga mazhoranca mbi deputetët e saj për të mos pasur asnjë mungesë parlamentare për shkak të nevojës për kuorum, siç edhe gjatë debateve në parlament vetëm një numër minimal deputetësh u angazhuan.

4.2. TRANSPARENCA E KUVENDIT DHE PROBLEMATIKAT E HAPJES NDAJ PUBLIKUT

Gjatë viteve të fundit Kuvendi ka ndërmarrë disa hapa pozitiv të hapjes ndaj publikut. Një numër aktesh që lidhen me pasqyrimin e të dhënave online, me natyrën konsultuese të aktivitetit parlamentar, me rregulla të reja më liberale bashkëpunimi me shoqërinë civile, etj, përbëjnë zhvillim pozitiv dhe e afrojnë Kuvendin me standardet e kërkuara/nevojshme. Megjithatë, këto përparime nuk janë kthyer ende në sistem pune nga ana e Kuvendit dhe nuk kanë krijuar një mekanizëm afatgjatë e të qëndrueshëm funksional të transparencës. ISP pati dy përvoja kritike me Kuvendin në drejtim të transparencës.

- Së pari, ISP informoi Kuvendin për projektin e tij të monitorimit të Kuvendit dhe parashtrori kërkesën për të pasur mundësi monitorimi të aktivitetit parlamentar, sidomos në komisionet parlamentare. Përgjigja zyrtare e Kuvendit ndaj ISP nuk ishte qartësisht pranuese dhe bashkëpunuese. Kuvendi la të kuptohet se praktika e monitorimit mund të kryhet kryesisht online dhe nuk siguroi akses specifik për stafin e ISP që do të angazhohej në monitorim. Për më tepër, Kuvendi kërkoi paraprakisht CV e stafit monitorues, projektin dhe marrëveshjen me donatorët, kërkesa që nuk bazohen në standardet e transparencës dhe që ISP i konsideroi si tendenca për të pamundësuar monitorimin aktiv të parlamentit.

- ▶ Së dyti, ISP për një sërë çështjes me interes të monitorimit adresoi kërkesa drejtuar Kuvendit bazuar në ligjin mbi të drejtën e informimit. Një prej aspekteve të kërkesave lidhej me përfitimet financiare të detajuara në zëra mbi bazën e ligjit, statusit dhe aktivitetit parlamentar të secilit nga deputetët. Kuvendi nuk iu përgjigj plotësisht pozitivisht asnjërës prej tri kërkesave duke mos na lejuar të kuptojmë përfitimet dhe devijimet e mundshme financiare të deputetëve për shkak të statusit, sidomos në çështjet e pagesave për komisionet, dietat, udhëtimet, etj.
- ▶ Për dy problematikat kritike të raportit, Kuvendi solli komentet e tij kundërshtuese, por që në thelbin e tyre konfirmojnë qëndrimin, gjetjen dhe vlerësimin e dhënë nga stafi i ISP. Për shembull, në disa kërkesa adresuar Kuvendit për të marrë informacion të detajuar mbi përfitimet financiare të deputetëve, honoraret, shpërblimet, pagesat për seanca e komisione etj, Kuvendi refuzoi përgjigjen e detajuar, duke ofruar shifrat fundore të pagesës mujore. Informacioni i dhënë nga Kuvendi na pamundësoi verifikimin nëse deputetët pa prezencë ne seancë apo në komisione kanë përfituar pagesa financiare për të kundërtën, pra për prezencën, ose të dhëna të tjera financiare jo korrekte, të cilat, sipas burimeve të ISP ekzistojnë dhe mbeten një problematikë për përmirësim në të ardhmen.

4.3. SISTEMI ONLINE I KOMUNIKIMIT ME DEPUTETËT, - JO FUNKSIONAL

Një nga objektet e monitorimit të ISP ishte edhe sistemi online i krijuar nga Kuvendi në funksion të deputetëve për komunikim me qytetarët.

- ▶ Nga të dhënat verbale të marra nga ISP rezultoi se ky sistem nuk është funksional, kryesisht për shkak se vetë deputetët nuk kanë treguar interes ndaj tij dhe se qytetarët nuk kanë informacionin e nevojshëm për ekzistencën dhe funksionimin e tij. Disa prej deputetëve shprehën rezerva për sistemin e komunikimit elektronik, duke theksuar se sistemi administrohet nga Kuvendi dhe për pasojë, korrespondenca është konfidenciale dhe ndaj mund të mos jetë e sigurtë.

- ▶ Rritja e sigurisë së sistemit elektronik, rritja e besimit të deputetëve tek sistemi, si dhe në tërësi praktika e pyetjeve adresuar deputetit mbetet një prej standardeve të transparencës dhe sfidë për punën e parlamentit të ardhshëm, në mënyrë që ky komunikim të bëhet institucional, transparent, i vazhdueshëm dhe efikas.
- ▶ ISP ka ndërmarrë nismën, me mbështetjen e FES për këtë periudhë kohore dhe më pas përmes një partneri të rëndësishëm perëndimor në Tiranë, për të krijuar një sistem të ri online të komunikimit midis deputetëve e zgjedhësve, si dhe për të luajtur rolin e moderatorit aktiv në këtë komunikim.

4.4. KUVENDI, ZYRA DEPUTETËSH NË VETËM 6 NGA 12 QARQET

Pavarësisht faktit se shumica parlamentare banon në Tiranë, Kuvendi, me mbështetjen edhe të partnerëve ndërkombëtarë (sidomos OSBE) ka nxitur zbatimin e vendimit të datës 11.11.2014 për hapjen e zyrave të deputetëve në 12 qendra qarqesh. Sipas raportit të progresit të KE mbi Shqipërinë (2016) “në pesë qytete kryesore (Fier, Kukës, Shkodër, Gjirokastrë dhe Korçë) janë hapur zyra zgjedhore dhe janë plotësuar me staf parlamentar. Zyra në Korçë funksionon mbi bazën ndërpartiake. Duhet të garantohet mbulimi i 12 qyteteve”.

- ▶ Kuvendi iu përgjigj kërkesës për informim të ISP duke ofruar të dhëna të detajuara për zyrat e hapura, korrespondencën zyrtare me Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe pushtetin vendor, si dhe inventarin e pajisjeve në zyrat funksionale.
- ▶ Deri në mars 2017 rezultoi se janë hapur zyra në gjashtë qarqe (Fier, Shkodër, Kukës, Korçë, Gjirokastrë dhe Vlorë). Përmes një shkresë zyrtare Kuvendi vuri në dijeni Institutin e Studimeve Politike se pamundësia e hapjes së zyrave në të gjitha qarqet lidhet me mungesën e zyrave të ofruara nga organet e qeverisë vendore.
- ▶ Referuar të dhënave të Kuvendit, janë deklaruar 10 (dhjetë) specialistë në qarqe në funksion të zyrave të deputetëve, nga 24 specialistë që duhej të ishin nëse do të ishin hapur zyrat parlamentarë në të gjithë vendin.

- Problematika e hapjes së zyrave edhe në qarqet e tjera mbetet e hapur edhe në vijim. ISP pyeti dhe mori përgjigje negative nëse Kuvendi disponon një material analitik mbi efektivitetin e deritanishëm të zyrave të hapura dhe pritshmëritë ndaj këtij investimi.

4.5. KUVENDI: ASISTENCA LIGJORE PËR DEPUTETET

Gjatë takimit me deputetë të ndryshëm, sidomos drejtuesit e komisioneve parlamentare më aktive, është ngritur si shqetësim mungesa e stafëve asistente të nevojshme, sidomos ekspertë ligjorë dhe shkruar të ligjeve. ISP iu drejtua Kuvendit për të marrë të dhënat mbi stafet aktuale të këshilltarëve.

- Sipas të dhënave zyrtare në Kuvend (30 mars 2017) janë në funksion të partive politike 5 (pesë) këshilltarë juridikë (dy grupi më i madh politik PS, dy grupi tjetër politik PD), si dhe 1 (një) këshilltar për grupet e tjera parlamentare (LSI, PR e PDIU).
- Gjithashtu Kuvendi informon në se në funksion të asistencës ligjore për deputetët janë edhe 5 këshilltarë të shërbimit të përafrimit

KESHILLTARET	GRUPI
Gentjana Boksi	Grupi PD
Agron Kulicaj	Grupi PD
Dorian Teliti	Grupi PD
Gazmend Bardhi	Grupi PD
Kledia Nelaj (Haska)	Grupi PS
Juliana Latifi	Grupi PS
Besion Ajazi	Grupi PS
Dritan Kaba	Grupi LSI
Rudina Qatipi	Grupi PDIU
Suela Kokoshi	Grupi PR


të legjislacionit, 6 këshilltarë për monitorimin e institucioneve të pavarura, si dhe 6 specialistë të kërkimit parlamentar. Kuvendi raporton se ka dy drejtori të veçanta, - shërbimi i komisioneve dhe shërbimi juridik. Në shërbimin e komisioneve punojnë 9 (nëntë) këshilltarë, kurse në shërbimin juridik punojnë 10 (dhjetë) këshilltarë.

- ▶ Në total janë 24 këshilltarë, në dukje numër i madh, por vetëm 5 (pesë) këshilltarë mbeten 100% në funksion të asistencës direkt të aktivitetit të grupeve parlamentare. numri i vogël i këshilltarëve dhe nevoja e madhe e Kuvendit për ekspertë cilësorë ligjorë janë disproporcionale dhe një çështje që lidhet direkt me cilësinë e punës së Kuvendit dhe të produkteve ligjore të tij.
- ▶ Kryetari i Kuvendit ka 5 (pesë) këshilltarë dhe 1 (një) ndihmës, nga të cilët vetëm 1 (një) është ekspert juridik, - të tjerët janë përzgjedhje kryesisht politike dhe me funksione politike e mediatike. Nga ana tjetër, zëvendëskryetarët e Kuvendit nuk kanë në organikë ekspert këshilltarë, por vetëm sekretarinë e zyrës.
- ▶ ISP monitori edhe regjistrimin e deklarimit të stafit në faqen online të Kuvendit dhe rezultoi se janë regjistruar në emër të partive politike 10 këshilltarë. PS ka 4 (katër) dhe PD k 3 (tre) këshilltarë, partitë e tjera nga 1 (një) këshilltar.
- ▶ Duke u interesuar për CV dhe formimin e tyre profesional, rezulton se në tërësi më shumë kemi të bëjmë me figura të besueshme politike të palëve respektive sesa ekspertë juridikë të aftë për të këshilluar çështje të thelluara juridike të grupeve respektive parlamentare.

4.6. RASTI “KLOSI” DHE NEVOJA PËR STANDARDE MË TË LARTA PROCEDURIALE

Rasti i shkarkimit të Ministrit Klosi (seanca plenare e datës 23 mars), paraqet një problematikë thelbësore në funksionin e parlamentit. Sipas procesverbalit të seancës theksohet *“kalojmë në dekretin nr. 10085, datë 19.03.2017 “Për shkarkimin e zotit Blendi Klosi, ministër i Mirëqenies Sociale dhe Rinisë”. Referenca është në bazë të nenit 98 të Kushtetutës. Procedura e votimit është një votim i hapur me elektronikë, me shumicë absolute votash për miratim. Hapet votimi me elektronikë. Mbyllet votimi. Miratohet me 70 vota pro, asnjë kundër, 2 abstenime”*.

Shkarkimi i një ministri mund të ndodhë vetëm nëse pro dekretit të Presidentit për shkarkimin votojnë më shumë se gjysma e të gjithë deputetëve, pra më shumë se 70 deputetë. Zoti Klosi mori 70 vota kundër, për pasojë dekreti për shkarkimin nuk mori votat e nevojshme për tu miratuar.



- Pavarësisht nga kjo, Kuvend vijoi me dekretin e emërimit të ministres Xhaçka, e cila zëvendëson ministrin Klosi. Emërimi ministër e znj. Xhaçka u miratua me 79 vota pro. Në këto rrethana, për të njëjtin post ishin në fuqi dy ministra, ministri që nuk mori votat e nevojshme për shkarkim dhe ministrja e re e zgjedhur.
- Pasi u mbyll votimi për dekretet dhe Kuvendi vijon punën, kryetari i grupit parlamentar të PS z.Gramoz Ruçi ndërhyri duke kërkuar ri-përsëritjen e votimit për shkarkimin e Ministrit Klosi dhe emërimin e Ministres Xhaçka. Ndërhyrja e tij nuk pati citim ligjor dhe vetë Kuvendi nuk e pa të nevojshme të interpretonte rishikimin e votimit, pavarësisht se votimi ishte plotësisht korrekt me Rregulloren e Kuvendit. Disa minuta më pas, Kuvendi votoi edhe njëherë për dy dekretet, tashmë me 76 vota për shkarkimin e Ministrit Klosi dhe po 76 vota pro dekretit për emërimin e ministrit të ri.
- Rregullorja e Kuvendit (neni 61) përcakton se “çdo votim i kryer në kundërshtim me Kushtetutën, ligjin ose Rregulloren e Kuvendit është i pavlefshëm. Drejtuesi i seancës, pasi merr mendimin e Sekretariatit për

Procedurat dhe Votimet, urdhëron anulimin e votimit dhe përsëritjen menjëherë të tij". Në këtë rast kjo praktikë procedurale e Rregullores nuk u zbatua, nuk pati mendim zyrtar të Sekretariatit për Procedurat dhe Votimet dhe as vendim për anulimin e votimit të mëparshëm. Në komentet e Kuvendit mbi këtë çështje të raportit monitorues të ISP theksohet se kjo situatë ndodhi për shkak të "pamundësisë për të votuar të disa deputetëve të pranishëm në sallë, për arsye të mosfunksionimit të panelit të votimit". Në faksimilen e procesverbalit të seancës, me burim Kuvendin, rezulton ndryshe dhe provohet vlerësimi i ekipit monitorues të ISP.

- Praktika të tilla krijojnë shqetësime në lidhje me saktësinë e procedurave të punës së Kuvendit dhe lehtësisht mund të jenë burim i debateve politike apo ankimeve në Gjykatën Kushtetuese. Në mënyrë që këto praktika të evitohen, Kuvendi do të duhet të jetë më transparent në aktivitetin e tij, si dhe aktet e Kuvendit do të duhen të marrin vëmendje më të madhe nga grupi i ekspertëve juridikë të kryetarit, të grupeve e të komisioneve parlamentare, ashtu edhe nga Sekretariati për Procedurat dhe Votimin në Kuvend.

4.7. KOMISIONI I EKONOMISË DHE STANDARDET ETIKE TË SHKARKIMIT NË AMF

Përmes një procedure të përshpejtuar parlamentare Kuvendi shkarkoi nga detyra Drejtoreshen e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare znj. Enkelejda Shehi me 55 vota pro dhe 20 kundër. Interesant është fakti se në dy mbledhjet e zhvilluara për këtë rast në Komisionin e Ekonomisë dhe të Financave, përgjegjës për rastin, pjesëmarrës dhe votues ka qenë edhe deputeti i mazhorancës Ervin Koci.

- Pas shkarkimit në seancë plenare më 16 mars të zonjës Shehi, i njëjti komision miratoi zgjedhjen në krye të AMF së deputetit Koci, i dorëhequr 24 orë më parë nga mandati parlamentar. Këshilli i Ministrave i propozoi Kuvendit kandidaturën e z. Ervin Koçi për anëtar të Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, i cili do të duhet të mbajë edhe funksionin e Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv të Autoritetit për periudhën e mbetur të mandatit të anëtarit të liruar nga kjo detyrë. Komisioni i Ekonomisë e miratoi kërkesën e KM në të

njëjtën ditë që Kuvendi në seancë plenare bëri edhe votimin formal të kandidaturës së tij për drejtor të AMF.

- Praktika të tilla të shkarkimit të zyrtarëve të lartë në varësi të parlamentit dhe të zëvendësimit nga deputetë që kanë qenë aktiv në shkarkimin e zyrtarit paraardhës, përbëjnë shqetësim etik për punën dhe standardet e transparencës dhe meritokracisë nga ana e Kuvendit të Shqipërisë në përgjithësi dhe në këtë rast, nga Komisioni mbi Ekonominë dhe Financat. Gjithashtu, zgjedhja e drejtuesve të institucioneve të pavarura financiare përmes kandidatëve politikë në Kuvend përbën shqetësim serioz mbi standardet e respektimit të pavarësisë së institucioneve.

4.8. AKTIVITETI NË KOMISIONE, - PROBLEMATIKA ME DETYRIMET NË RREGULLORE

Rregullorja e Kuvendit të RSH, miratuar me vendim nr.166, datë 16.12.2004, ndryshuar 2005, 2008, 2010, 2011, 2013 dhe së fundi, me datë 27.11.2014 përcakton rregullat e funksionimit të institucionit të Kuvendit, të seancës plenare, komisioneve, procedurave, vendimmarrjes, etj. Dokumenti i rregullores është miratuar zakonisht me konsensus politik midis shumicës dhe pakicës parlamentare, në mënyrë që rregullat e shkruara të jenë efikase dhe afatgjatë, të pranura dhe të zbatuara nga të gjitha palët politike.

- Sipas nenit 40, pika 2 e Rregullores, *“anëtarët e komisionit duhet të marrin pjesë rregullisht në mbledhjet e komisionit. Kur një anëtar i tij mungon pa shkaqe të arsyeshme për më shumë se tri mbledhje rresht gjatë një sesioni, komisioni mund të vendosë që kryetari i komisionit t’i kërkojë, në seancë plenare, grupit parlamentar përkatës zëvendësimin e anëtarit të komisionit”*. Zbatimi i kësaj pike të rregullores vijon të ketë probleme.
- Nga të dhënat e monitorimit gjatë vitit 2016 dhe gjatë sesionit 2017, rezulton se disa deputetë, përfshirë ish kryeministrin Berisha, Kryemadhi, Idrizi, etj. nuk kanë marrë pjesë në asnjë prej mbledhjeve të Komisioneve Parlamentare, madje Berisha është i vetmi deputet që nuk është as anëtar në ndonjë komision. Në asnjërin rast nuk kemi

angazhim të drejtuesve të komisioneve apo të Kuvendit për zbatimin e kërkesave të rregullores.

4.9. DEBATI I LIRË 60 MIN? ABUZIM ME NORMAT E RREGULLORES

Rregullorja e Kuvendit, neni 45, përcakton se në fillim të seancave plenare deputetët mund të diskutojnë për çështje jashtë rendit të ditës, dhe ky diskutim “nuk mund të jetë më shumë se 60 minuta”. Deputetët mund të diskutojnë jo më shumë se 5 minuta, përfaqësuesit e grupeve parlamentare jo më shumë se 8 minuta. Nëse kalohet ky afat, Kryetari i Kuvendit ndërpret diskutimet e deputetëve dhe atyre që kanë ngelur pa diskutuar u jepet fjala në fund të seancës plenare pasardhëse.

- ▶ Nga praktika e punës së Kuvendit gjatë vitit 2016 dhe 2017 ka rezultuar në vijimësi që seanca e debatit për çështje jashtë rendit të ditës kanë zgjatur shumë më tepër se 60 minuta dhe se diskutues të veçantë, përfshirë dy figurat kryesore të dy partive më të mëdha, kryeministri Rama dhe ish kryeministri Berisha, kanë diskutuar pa limit kohor dhe disa herë brenda të njëjtës orë parlamentare. Në raste të tilla të shpeshta Rregullorja dhe e drejta e deputetëve të tjerë është shkelur.
- ▶ Edhe përcaktimi i rregullit të vijimit të diskutimeve në fund të seancës plenare pasardhëse nuk është respektuar. Siç rezulton edhe nga procesverbalet e Kuvendit, në shumicën e rasteve debatet politike jashtë rendit të ditës kanë ndodhur në fillim të seancës, jo në fundin e saj. Pretendimi i Kuvendit në komentet e tij se ka ndodhur e kundërta, dhe madje se “në këtë legjislaturë nuk janë zhvilluar diskutime për çështje jashtë rendit të ditës” - lehtësisht janë të verifikueshme edhe nga procesverbalet e Kuvendit si të pasakta. Në dy këto elementë të rregullores nuk ka pasur ndërhyrje nga Kryesia apo Kryetari i seancës për të respektuar praktikën e përcaktuar në Rregullore.

4.10. PRAKTIKA E PUBLIKIMIT TË DISKUTIMEVE: PARIMI VS BUOKRACIA

Sipas nenit 44 të Rregullores në fillim të çdo seance plenare Kuvendi miraton procesverbalin e seancës së mëparshme, përpara se ai të publikohet në faqen zyrtare të internetit të Kuvendit. Ndërkohë, sipas nenit 54 “procesverbalet publikohen në faqen e internetit të Kuvendit” dhe se “diskutimet në seancat plenare botohen të plota”. Ka dy elementë që përbëjnë shqetësim.

- ▶ E para, nga njëra anë kemi detyrimin e publikimit të procesverbaleve dhe nga ana tjetër detyrimin që përpara publikimit dokumenti të miratohet në seancë plenare. Në rastet e zhvillimeve politike fundore, - krizave politike, bojkoteve, mbylljes së sesioneve parlamentare, etj, (së fundi ndodhi edhe me seancën e fundit të legjislaturës dhe më pas edhe me seancën e jashtëzakonshme të muajit maj) në pritje të seancës së radhës për procedurën formale të miratimit, procesverbali nuk është bërë publik në faqe interneti. Për pasojë, qytetarët dhe subjektet e interesuara duhet të presin sesionin më të ri parlamentar (seancën e jashtëzakonshme të datës 24 korrik ose seancën e parë të muajit shtator 2017) për të pasur sukses në internet me procesverbalin e seancës së jashtëzakonshme të datës 22 maj 2017. Për rregullimin e kësaj problematike do të duhet të ketë një ndryshim në Rregullore ose vendim procedural të Byrosë/Konferencës së Kryetarëve për lehtësimin e praktikës dhe dhënies shumë më tepër prioritet detyrimit për transparencë sesa detyrimit teknik procedural.
- ▶ E dyta, Rregullorja përcakton detyrimin që në procesverbalin e publikuar të shënohet “data e zhvillimit të seancës plenare dhe rendi i ditës së saj, pjesëmarrja e deputetëve, përmbledhja e diskutimeve dhe e qëndrimeve të mbajtura nga deputetët, si dhe rezultatet e votimit”. Ky rregull ka nevojë për specifikim më të detajuar, rreth koncepteve “pjesëmarrje e deputetëve”, “votimit”, dallimit midis “diskutime” dhe “qëndrime” etj, sepse duke pasur paqartësi në kuptimin e tyre lehtësisht pasqyrohen probleme edhe në mënyrën sesi reflektohen ato në procesverbalet e publikuara online në faqen zyrtare të Kuvendit.

4.11. DEKRIMINALIZIMI, - DEPUTETËT E HEQUR VIJOJNË TË GËZOJNË PRIVILEGJE


Bazuar në ligji 8850, datë 18.11.1999 “Mbi statusin e deputetit”, neni 16, “deputetit dhe bashkëshortes (bashkëshortit) të tij/saj u njihet e drejta e pajisjes me pasaportë diplomatike gjatë kohës së kryerjes së mandatit, si dhe 3 vjet pas mbarimit të tij..... Imuniteti diplomatik i deputetit garantohej nga shtetet e tjera sipas detyrimeve që rrjedhin nga konventat ndërkombëtare”. Ky është një rregull klasik, por që në rastin shqiptar paraqet një problematikë tjetër.

- ▶ Gjatë 2016-2017 pesë deputetë dorëzuan mandatin parlamentar ose iu hoq mandati parlamentar në kuadër të neneve të ligjit të dekriminalizimit. Ky është rasti i parë gjatë tranzicionit kur politikanët humbasin mandatin parlamentar për shkak të kufizimeve nga një ligj specifik. Me gjithë masën e ashpër dhe dorëzimit të mandatit, Kuvendi nuk e reflektoi frymën e re të ligjit të dekriminalizimit në aktivitetin e tij parlamentar dhe legjislacionin rregullator brenda tij.
- ▶ Konkretisht, të gjithë deputetët e dorëhequr ose me mandat të hequr vijojnë të gëzojnë privilegjet ligjore të statusit të ish deputetit, përfshirë edhe mbajtjen e pasaportës diplomatike për veten e tij dhe bashkëshorten. ISP pati një komunikim intensiv me Kuvendin dhe Ministrinë e Jashtme për këtë problematikë. Kuvendi nuk pranoi të japë informacion për ish-deputetët e famijarët e tyre që kanë pasaportë diplomatike bazuar në Statutin e deputetit, kërkesë që gjithashtu u refuzua edhe nga MPJ, në dy rastet, në kundërshtim me ligjin mbi të drejtën e informimit. Për pasojë ISP e ankimoi praktikën jo ligjore të Kuvendit dhe të MPJ tek Komisioneri për të Drejtën e Informimit, i cili u kërkoi dy institucioneve të zbatojnë pozitivisht kërkesën e ISP. Mbi bazën e këtij komunikimi, por edhe informacionet shtesë të siguruara nga stafi i ISP, deputetët e identifikuar si të inkriminuar vijojnë të përdorin pasaportën diplomatike dhe e kanë përdorur atë në udhëtime të ndryshme jashtë vendit edhe gjatës kohës kur e kanë humbur mandatin parlamentar.
- ▶ ISP i ka sugjeruar Kuvendit të bëjë ndërhyrje dhe reflektime specifike në ligjin mbi Statusin e Deputetit dhe të krijojë lidhje organike midis ligjit të dekriminalizimit dhe privilegjeve që burojnë/humbasin në bashkëveprimin midis statusit dhe këtij ligji.



TË DHËNA MBI AKTIVITETIN DHE BILANCIN LEGJISLATIV

Gjatë periudhës së monitorimit të Kuvendit, rezulton se janë zhvilluar 23 seanca plenare, por në dy raste, kemi pasur dy seanca brenda të njëjtës ditë. Kohëzgjatja e seancave ka qenë 72.08 orë ose 3.13 orë mesatare për seancë. Në praktikën e vendeve kryesore evropiane mesatarja për seanca shkon 2-3 herë më e madhe, për shkak se seanca kryhen funksione thelbësore të debatit politik dhe të shqyrtimit dhe miratimit final të ligjeve.



- ▶ Duke pasur parasysh se sesioni i pranverës 2017 ishte edhe sesioni kur një numër institucionesh kushtetuese do të duhet të raportojnë në Kuvend mbi aktivitetin e tyre vjetor, atëherë axhenda parlamentare do të duhej të ishte dyfish më intensive. Fakti se axhenda ka pasur akte minimale në debat, flet për efikasitetin e parlamentit në ushtrimin e aktivitetit të tij thelbësor, ligjvënës, si dhe efikasitetin minimal të qeverisë, deputetëve dhe institucioneve të tjera që kanë akses në furnizimin e parlamentit me nisma ligjore.
- ▶ Nga rreth 92 akte që Kuvendi kishte parashikuar të ishin pjesë e axhendës parlamentare prill-maj 2017, Kuvendi shqyrtoi më pak

se 50% të tyre. Disa ligje dhe akte parlamentare, përfshirë Kodi i Etikës si dhe shumica e nismave individuale të deputetëve, përfshirë edhe një nismë e ndërmarrë nga kryeministri Rama, me cilësinë e deputetit, nuk u bënë pjesë e seancave plenare dhe e vendimmarrjes parlamentare. Raste si këto të fundit, tregojnë se nisma ka qënë e motivuar politikisht në një moment të caktuar dhe jo një iniciativë serioze, përndryshe, mazhoranca e drejtuar prej tij ka të gjithë instrumentat për ta debatuar dhe miratuar.

- ▶ Disa nisma të tjera depuettësh, përfshirë dy nisma të deputetes Bregu, një nismë e grupit të LSI mbi Kodin Rrugor, dy nisma të vecuara mbi Kodin Zgjedhor nga deputeti Balla dhe deputeti Bylykbashi, nisma për ligjin mbi dekoratat apo nisma e deputetes Doda mbi titujt nuk u përfshinë në axhendën parlamentare dhe mbeten de facto jashtë trajtimit ligjor, në kundërshtim me rregulloren.
- ▶ Problematika të shtyrjeve të akteve dhe vonesave në miratim nuk lidhet vetëm me numrin e madh të akteve të mbetura në kuadër propozimi dhe të pakonsumuara nga Kuvendi, por sidomos me shkurajimin që parlamenti i bën nismave nominale të deputetëve dhe çështjeve që nuk përbëjnë interes të drejtpërdrejtë politik të shumicës parlamentare.
- ▶ Një numër deputetësh i janë adresuar ISP me tezën se për një parlament nuk ka rëndësi numri i akteve të miratuara sa kanë rëndësi cilësia e akteve dhe se një numër ligjesh, sidomos për reformën në drejtësi, kanë pasur numër rekord nenesh, për të cilat është marrë shumë më tepër kohë sesa për ligje të zakonshme. Kjo pikëpamje qëndron, por ISP vlerëson se Kuvendi do të duhet të ushtrojë më shumë presion pozitiv mbi ekzekutivin mbi cilësinë e draft-ligjeve dhe për afatet kohore të ardhjes së tyre.


5.1. VOTA POLITIKE E DEPUTETËVE? NJË PARLAMENT BESNIK NDAJ “PARTISË”

Gjatë sesionit parlamentar janar – maj 2017 janë pasqyruar në faqen zyrtare të Kuvendit votimet e deputetëve për 91 akte ligjore të miratuara. Pasqyrimi i

votës, sipas rregullores, pati probleme vonese vetëm në periudhën mars-prill të mungesës së opozitës në parlament. Duke e konsideruar çështje teknike, vonesa nuk përbën devijim nga standardet.

- ▶ Leximi i votës së deputetëve në parlament nxjerr në pah lidhjen e fortë të tyre me partinë politike. Rastet e votimit politik janë 100% në përputhje me vendimin politik të partisë. Megjithëse deputetët mund të kenë mendime të ndryshme lidhur me ligje të caktuara, bindja ndaj vendimit politik u jep partive rol thelbësor në vendimarrjen parlamentare. Edhe deputetët kritikë brenda partive të tyre, mbeten kritikë formalë, për sa kohë vota e tyre në parlament ka shkuar rregullisht pro orientimit politik.
- ▶ Rastet përjashtimore nga kjo praktikë, janë minimale dhe lidhen me akte teknike, jo politike. Përjashtim bëjnë deputetët e LIBRA Blushi dhe Hafizi, të cilët kanë pasur votime të përbashkëta për të gjitha aktet e Kuvendit nga janari 2017. Kështu, të dy deputetët kanë votuar kundër në rastin e ligjit *“Për pagesën dhe fshirjen e pjesshme të detyrimeve tatimore, detyrimeve të pagueshme në doganë si dhe procedurën e heqjes nga qarkullimi të mjeteve të transportit pas fshirjes së detyrimeve tatimore”*.
- ▶ Dy deputetët e LSI, Kryemadhi dhe Mehmetaj kanë votuar së bashku kundër projektligjit *“Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”*. Po ashtu, dy deputetët e PS—së Erjon Brace dhe Dashamir Peza kanë votuar kundër projektligjit *“Për sportin”*.
- ▶ Dy deputetët veteranë në politikë Namik Dokle e Arta Dade kanë abstenuar në një votim, përkatësisht, Dokle në votimin e Projektligjit *“Për negocimin e marrëveshjes, ndërmjet shtetit shqiptar dhe kompanisë “Al Habtoor Investment LLC”, Për projektimin dhe ndërtimin e “Kullës Ikonike”, në Tiranë”,* si dhe Dade në projektligjin *“Për miratimin e shtesës së marrëveshjes së koncesionit, ndërmjet ministrisë së Energjisë dhe Industrisë, si autoritet kontraktues, dhe NESKO METAL SAN.TIC.A.S, si koncesionari, për disa objekte të industrisë së bakrit dhe të kromit”*.
- ▶ Deputeti Spartak Braho (zgjedhur në listën e PS, por de facto deputet i LSI, ka abstenuar në 3 votime,- në votimin për dy ratifikime të dy kredive gjermane që lidhen me programe investimi në infrastrukturë dhe shërbime sociale, si dhe në një akt miratimi të një rezolute procedurale që lidhet me Bankën Islamike për Zhvillim.

5.2. PARLAMENTI, 13 LIGJE NË PESË MUAJ, DOMINUES AKTET RUTINORE



Sesioni aktual parlamentar ka nisur në muajin janar dhe vijon deri në fillim të muajit maj 2017. Gjatë periudhës 10 janar – 20 shkurt 2017 parlamenti funksionoi në rrethana optimale, përmes debatit politik parlamentar midis mazhorancës dhe opozitës, dhe praktikave normale të vendimarrjes. Pas 20 shkurtit dhe deri në maj 2017 parlamenti ka vijuar funksionin pa praninë e opozitës, por duke pasur bilanc më modest rezultatesh sesa në periudhën e prezencës së opozitës.

- Referuar të dhënave zyrtare, Kuvendi gjatë periudhës 1 janar – 31 maj 2017 ka miratuar 57 akte parlamentare në prezencën e opozitës në parlament dhe 125 akte parlamentare pa praninë e saj. Në total dominuese kanë qenë aktet rutinore parlamentare, siç janë vendimet (81) dhe ratifikimet (43). Amendimet ligjore vijnë në radhë për tu ndjekur më pas nga ligjet dhe rezolutat parlamentare.

Seancat	Ligje	Ven- dime	Amen- dime	Rezo- luta	Ratifi- kime	Numri
16.01.2017	0	2	0	0	0	2
26.01.2017	1	0	1	0	3	5
02.02.2017	2	7	1	0	3	13
09.02.2017	1	4	1	0	0	6
16.02.2017	1	0	3	0	0	4
23.02.2017	1	0	0	0	2	3
02.03.2017	0	0	0	1	3	4
06.03.2017	0	2	0	0	0	2
09.03.2017	1	2	1	1	0	5
16.03.2017	1	3	0	0	0	4
23.03.2017	0	11	3	0	2	16
30.03.2017	2	3	8	0	0	13
06.04.2017	0	5	4	3	0	12
11.04.2017	0	2	0	0	0	2
13.04.2017	0	3	2	2	8	15
18.04.2017	0	2	0	0	0	2
20.04.2017	0	3	3	0	10	16
27.04.2017	2	4	2	1	6	15
28.04.2017	0	2	0	0	0	2
04.05.2017	1	2	1	4	6	14
22.05.2017	0	24	3	0	0	27
Total	13	81	33	12	43	182

- Referuar në terma konkretë, janë miratuar vetëm 13 ligje, nga të cilat, 5 në prani të opozitës dhe 8 pa praninë e saj parlamentare; 37 vendime në prezencë të opozitës dhe 44 pa praninë e saj, 9 amendime ligjore në prani të opozitës dhe 24 pa praninë e saj, 12 rezoluta pa praninë e opozitës dhe asnjë në praninë e saj, si dhe 37 ratifikime pa praninë e opozitës ndaj 6 ratifikimeve me praninë e saj. Duke marrë parasysh faktin se vetëm në një ditë (22 maj) janë miratuar 27 akte parlamentare konsensuale, nga të cilat 24 vendime


dhe 3 amendime ligjore, atëherë rezulton se produkti parlamentar mesatar gjatë periudhës tjetër të punimeve ka qenë minimal.

- ▶ Në total në numrin e ligjeve të reja nuk bëjnë pjesë asnjë prej ligjeve thelbësore mbi të cilën do të mund të ngrihej një reformë strukturore apo funksionale. Shumica janë ligje dytësore, për problematika sociale, si p.sh, ligji për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e ri-novueshme, ligji për administrimin e ujitjes dhe kullimit, ligji për të drejtat e fëmijëve, ligji për statusin e punonjësve të naftës e gazit, ligji për sigurinë kibernetike, ligji për sportin dhe ligji për produktet kozmetike.

5.3. NË DY DITË, MË SHUMË LIGJE SESA 3 MUAJ SË BASHKU

Gjatë seancës plenare të 30 marsit 2017 mazhoranca dhe partitë e tjera pjesëmarrëse në parlament (Libra), votuan disa prej ligjeve më të rëndësishme të sesionit parlamentar, - një paketë ligjesh mbi reformën në drejtësi.

- ▶ Konkretisht, u votua ligji “Për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë” me 86 vota pro, “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë” me 88 vota pro, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë” me 88 vota pro, “Kodi i Drejtësisë për të Mitur” me 88 vota pro, “Kodi i Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë” me 87 vota pro, “Ligji për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” me 88 vota pro, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë” 86 vota pro.
- ▶ Në të njëjtën seancë u miratuan edhe akte të tjera, përfshirë ligji për fshirjen e Detyrimeve Tatimore, për lirin e frekuencave dixhitale, si dhe ndryshimet në ligjin “Për nëpunësin civil të ndryshuar”.
- ▶ Në seancën tjetër të datës 22 maj, kuvendi miratoi të gjitha dekretet e Presidentit për shkarkim dhe emërim ministrash, bëri ndryshime në legjislacionin penal që lidhet me zgjedhjet, në ligjin mbi partitë politike, në legjislacionin mbi median dhe gjithashtu bëri zgjedhjen e Avokatit të Popullit dhe të Kryetarit të KQZ. Në këtë seancë u



morën edhe vendime të tjera, kryesisht procedurale, në zbatim të detyrimeve nga marrëveshja politike midis PD e PS.

- ▶ Vlen të theksohet fakti se vendimet e marra në këto dy seanca përbëjnë numër shumë më të madh ligjesh dhe aktesh të rëndësishme ligjore sesa për një periudhë tre mujore së bashku. Kontraste të tilla shpjegohen me emergjencën dhe presionin pozitiv ndërkombëtar për miratimin e ligjeve në mars për reformën në drejtësi, si dhe me rastet e kompromiseve të mëdha politike. Të dy këto tipare nxjerrin në pah mungesën e një strategjie të qëndrueshme të punës së Kuvendit dhe ndryshimin e axhendës parlamentare në varësi nga zhvillimet politike afatshkurtra të ditës politike.

5.4. SESIONI 2017: REKORD SEANCASH TË JASHTËZAKONSHME

Në traditën e brishtë parlamentare shqiptare seancat e jashtëzakonshme janë zhvilluar kryesisht për zgjidhjen e krizave politike ose përmes kërkesës politike së ardhur nga ndonjë shtet perëndimor partner me rëndësi për Shqipërinë. Kuvendi këmbëngul se nga ana formale Kushtetuta i jep të drejtën kryeministrit ose 1/5 të deputetëve të thërrasin seancë të jashtëzakonshme, sqarim korrekt nga ana formale. Gjithsesi, është i njohur fakti se një sërë aktesh ligjore të parlamentit, sidomos ato në fushën e reformës në drejtësi, janë produkt i kërkesës, këshillës ose presionit politik të partnerëve tanë ndërkombëtarë, kryesisht Bashkimi Evropian dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

- ▶ Dy nga seancat e jashtëzakonshme u thirrën nga Kuvendi në funksion të miratimit të komisioneve të vettingut, (11 prill dhe 17 qershor), kurse seanca e tretë e jashtëzakonshme u thirr nga kryeministri për të jetësuar zgjedhjen e disa funksionarëve të lartë në zbatim të marrëveshjes politike midis Partisë Socialiste dhe Partisë Demokratike (22 maj). Është interesant fakti se Kuvendi, në komentet mbi raportin e ISP kundërshton zhvillimin e tre seancave dhe citon vetëm dy seanca, - një pasaktësi në shifra dhe vlerësim prej tij.
- ▶ Seanca më e rëndësishme e jashtëzakonshme ishte ajo e datës 22 maj, në të cilin u votuan dekretet e Presidentit për emërimin e zv/kryeministrit dhe të gjashtë ministrave të rinj, u bënë ndryshime në Ligjin mbi Partitë Politike dhe në Kodin Penal, u miratuan anëtarët e pakicës parlamentare në tre komisionet e vettingut, si dhe u votuan kryetari i KQZ dhe Avokati i Popullit, etj.

5.5. NDRYSHIMET KONSENSUALE, - PROCEDURA TË SHPEJTA, PA TRANSPARENÇË

Disa prej vendimeve të Kuvendit në sesionin e jashtëzakonshëm u shoqëruan me mungesë të dukshme transparence dhe me procedura formale.

- ▶ Për shembull, Kuvendi shpalli vende vakant për postin e Avokatit të Popullit dhe për Kryetarin e KQZ, në përpjekje për të qenë “korrekt” me praktikën kushtetuese e ligjore. Në fakt, vendi vakant u shpall në orën 14:00 dhe afati i aplikimeve ishte vetëm dy orë, deri në orën 16:00. Njoftimi u publikua në faqen zyrtare të Kuvendit, por media dhe individët e interesuar nuk kishin mundësi të informoheshin në limitet e kohës në dispozicion, dhe për më tepër, nuk kishte kohë teorike e praktike që individë të interesuar të aplikonin. Shpallja e dy vendeve vakant u bë në rrethanat kur emrat ishin paracaktuar dhe kur votimi për dy personat e votuar, ishte çështje formaliteti, bazuar në akordin e mëparshëm midis Partisë Socialiste dhe Partisë Demokratike.
- ▶ E njëjta praktikë e nxituar u aplikua edhe për zgjedhjen e kryetarit të ri të KQZ. Për rastin e KQZ palët ranë dakord që kryetari t’i kalojë opozitës pa marrë në konsideratë gjendjen e mandateve në KQZ, dhe pavarësisht faktit se ligji përcakton se kryetari nuk është partiak, është produkt i konkurrencës së lirë në Kuvend. Në dy rastet, si për kryetarin e KQZ dhe Avokatin e Popullit personat u caktua në funksion në kundërshtim të plotë me të gjithë praktikën kushtetuese dhe ligjore që duhej të ndiqte Kuvendi i Shqipërisë.
- ▶ Duhet theksuar se nxitimi për të jetësuar “ligjërisht” paktet politike u pasua me mbledhje të shpejta e formale edhe të komisioneve përkatëse të Kuvendit, si dhe me përgatitje të nxituar e formale të dosjes nga administrata e Kuvendit për kandidatët e paracaktuar për këto dy poste. Praktika të tilla, pavarësisht vullnetit politik të palëve politike, dëmtojnë seriozisht integritetin e Kuvendit dhe seriozitetin e veprimtarisë dhe vendimmarrjes së tij.

5.6. KUVENDI, NUK PËRMBUSHI VENDET VAKANTE NË INSTITUCIONET E VARËSISË

Një prej funksioneve të Kuvendit është edhe plotësimi në afat të vendeve vakante në institucionet në varësi të tij. Gjatë vitit 2017 Kuvendi u përball me probleme funksionimi dhe vendimmarrjeje në lidhje me ushtrimin e këtij funksioni. Procesi për zgjedhjen e Avokatit të Popullit u shoqërua me shtyrjen e afateve të aplikimit për kandidatët, si dhe me debate ligjore e politike nëse shtyrja kishte bazë ligjore apo bazohej në argument politike.

- ▶ Në fund të procesit as kandidatët e parë dhe as ata të regjistruar në fazën e dytë të shtyrjes, nuk u përfshinë në garën reale për Avokatin e Popullit. Kuvendi, sic u citua më lart, ndoqi një procedurë të re emergjence, e cila çoi në zgjedhjen pa konkurrim të Avokatit të Popullit.
- ▶ Një prej përgjegjësive të Kuvendit ishte edhe zgjedhja e anëtarëve të Bordit të Institutit të Studimeve për Krimet e Komunizmit në Shqipëri. Mandatet e anëtarëve të bordit kanë përfunduar më 22.7.2015, pra prej dy vitesh. Gjatë viteve 2016 dhe 2017 parlamenti nuk nisi procedurat e zëvendësimit të tyre. Kuvendi miratoi një rezolutë vjetore 2017 mbi punën e këtij institucioni dhe njohu përgjegjësinë e tij për mos-zgjedhjen e anëtarëve të Bordit. Ai i caktoi vetvetes detyrë që gjatë muajve në vijim 2017 *“t’u kërkojë subjekteve që propozojnë anëtarët e Bordit të ISKK-së fillimin e procedurave përzgjedhëse dhe depozitimin e kandidaturave në Kuvendin e Shqipërisë”*.
- ▶ Kuvendi në komentet e tij mbi këtë pikë kritike, pranon përgjegjësinë dhe thekson se procesi është drejt mbylljes dhe se zgjedhja e anëtarëve të rinj do të mund të bëhet në fillim të legjislaturës së re. Vlen për tu theksuar se nëse kjo ndodh, kemi të bëjmë gjithsesi me një periudhë më shumë se dy vjeçare vonesë dhe funksionim të një institucioni pa mandat, për shkak të përgjegjësisë së Kuvendit në përmbushjen e detyrave të tij.



**TË DHËNA MBI
DEPUTETET:
KONTRIBUTI NE
SEANCA DHE NE
KOMISIONET
PARLAMENTARE**

Një nga elementët thelbësor që tregojnë edhe cilësinë e përfaqësimit dhe të aktivitetit parlamentar të deputetëve është angazhimi i tyre në debatet politike parlamentare, në debatet mbi ligjet, në nismat ligjore dhe në debatet profesionale e politike në komisione. Përmes pjesëmarrjes në debate deputetët krijojnë bilancin e tyre përfaqësues në raport me zonën elektorale, krijojnë imazhin publik dhe perceptimin ndaj tyre. Përmes debateve në komisionet parlamentare, propozimet dhe mendimet që iu bëhen projektligjeve deputetët shfaqin aftësinë e tyre ligjvënëse.

6.1. DEPUTETËT MË AKTIV NË PARLAMENT 2017

Tabela e numrit të diskutimeve në seancat plenare reflekton vetëm angazhimin numerik, duke mos marrë në konsideratë dy elementë të tjerë të rëndësishëm: faktin se në gjysmën e sesionit pranveror të Kuvendit opozita nuk ishte e pranishme në Kuvend, si dhe përmbajtjen e diskutimeve,

DEPUTETËT MË ME SHUMË DISKUTIME PARLAMENTARE 2017			
DEPUTETET	DISKUTIME	DEPUTETET	DISKUTIME
Ben Blushi	15	Silva Caka	5
Mimoza Hafizi	10	Mesila Doda	5
Taulant Balla	9	Adelina Rista	4
Ervin Bushati	8	Andrea Marto	4
Erion Brace	7	Anila Agalliu	4
Edi Rama	7	Besnik Baraj	4
Erjeta Alhysa	6	Edmond Leka	4
Sali Berisha	6	Eduard Shalsi	4
Fatmir Toci	6	Jozefina Topalli	4
Gramoz Ruci	6	Namik Kopliku	4
Antoneta Dhima	6	Pjerin Ndreu	4
Vasilika Hysi	6	Xhemal Qefalia	4

Burimi: Instituti i Studimeve Politike: www.isp.com.al - Monitorimi i parlamentit 2017

nëse ato janë diskutime cilësore që lidhen me zonën zgjedhore, alternativat politike apo janë debate politike të zakonshme, kryesisht replika dhe retorika të konsumimit të ngjarjeve të ditës. Në monitorimin e legjislaturës së re ky element analitik i monitorimit të fjalimeve në seancat plenare do të zërë një vend të rëndësishëm.

Referuar të dhënave rezulton se gjatë sesionit të pranverës 2017 deputeti më aktiv në diskutimet parlamentare ishte Ben Blushi. Një kritik i ashpër i qeverisë dhe themelues i një partie të re politike, Blushi diskutoi në 15 nga 21-23 seancat aktive parlamentare, dhe në total, në 15 nga 17 seancat ku kishte diskutime parlamentare. Pas tij, gjithashtu deputeti më me shumë diskutime është Mimoza Hafizi, bashkëthemeluese e LIBRA bashkë me Blushin.

- ▶ Nga PS deputeti më me shumë diskutime është Taulant Balla, kryesisht me fjalime politike adresuar opozitës ose me fjalime – replika ndaj Blushit dhe kritikëve të tjerë. Ervin Bushati ka shifër të lartë diskutimesh, por shumica e tyre janë diskutime që vijnë për shkak të funksionit të tij në komision ose me cilësinë e relatorit.
- ▶ Edi Rama dhe Erjon Brace kanë të njëjtin numër diskutimesh. Fakti që kryeministri ka më pak diskutime sesa kryesuesit e listës së diskutantëve lidhet me mungesën e opozitës në parlament dhe për pasojë, mungesën e vëmendjes dhe të interesit të tij për replika politike. Të gjitha diskutimet e tij lidhen kryesisht me deklarime politike të momentit dhe replika ndaj një prej dy deputetëve të vetëm kritik në parlament, z.Blushi, siç ndodhi edhe në seancën e fundit të Kuvendit më 22 maj.
- ▶ Gjashtë deputetë kanë nga gjashtë diskutime, - kryesisht përfaqësuese të komisioneve parlamentare ose relatorë të ligjeve të caktuara. Midis tyre përjashtim bën ish kryeministri Berisha, i cili ka diskutuar në çdo seancë të prezencës së tij në Kuvend.

6.2. CILËT JANË 48 DEPUTETËT “E HESHTUR” TË PARLAMENTIT 2017

Në listën e deputetëve “të heshtur” për sesionin parlamentar të vitit 2017 kemi numër rekord deputetësh, në krahasim me sesionet parlamentare të viteve 2015-2016. Janë 48 deputetë që nuk janë përfshirë në debate

DEPUTETËT E “HESHTUR” GJATE VITIT 2017

Agron Cela	LSI	Liljana Elmazi	PD
Alban Zeneli	PD	Luan Duzha	LSI
Alfred Peza	PS	Luljeta Arapi	PS
Anduel Xhindi	PS	Mira Shehu	PS
Aqif Rakipi	PDIU	Mirela Ferracaku	PKD
Arben Cuko	PS	Monika Kryemadhi	LSI
Arben Imami	PD	Musa Ulqini	PS
Astrit Veliaj	PD	Namik Dokle	PS
Bashkim Fino	PS	Nard Ndoka	PDK
Bedri Mihaj	PD	Parid Cara	PS
Bujar Derveni	LSI	Paulin Sterkaj	PS
Dashamir Kamberi	PS	Perparim Spahiu	LSI
Dashamir Peza	PS	Petrit Vasili	LSI
Dashamir Shehi	PD	Sadri Abazi	PS
Edlira Cekrezi	LSI	Shkelqim Cani	PS
Edmond Zejno	PDIU	Shkelqim Troplini	PS
Eduard Selami	PD	Spartak Braho	LSI
Fatmir Xhafa	PS	Tahir Muhedini	PDIU
Fidel Ylli	PS	Ulsi Manja	PS
Genc Ruli	PD	Vangjel Tavo	LSI
Gjovalin Bzhetaj	PD	Vladimir Kosta	PS
Gjovalin Kadeli	LSI	Xhevit Bushaj	PS
Illir Xhakolli	PS	Ylli Shehu	LSI
Keltis Kruja	PD	Ylli Zicishti	PS

Burimi: Instituti i Studimeve Politike: www.isp.com.al - Monitorimi i parlamentit 2017

parlamentare, nuk kanë diskutuar për lidhet ose mbi problematika të veçanta, nuk kanë pasur nisma ligjore dhe nuk e kanë shfrytëzuar tribunën parlamentare për deklarime politike.

Në listë bëjnë pjesë emra të njohur të politikës, drejtues të partive politike,

disa drejtues aktiv të komisioneve parlamentare, si dhe një listë e gjatë njerëzish të biznesit, të cilët tradicionalisht nuk kanë qenë diskutues në parlament.

Interesant është fakti se rreth 20-21 prej tyre janë përfshirë në listat e rikandiimit në partitë e tyre politike në zgjedhjet e 25 qershorit, shumica e tyre në vende kryesuese të listës. Nëse i referohemi kontributit parlamentar, karriera e tyre në partitë politike do të kishte

njohur rënie, por për shkak se partitë aplikojnë kritere të tjera promovimi, ata janë kualifikuar, pavarësisht gjurmës negative që kanë lënë në memorien e aktivitetit parlamentar.

Në listë janë edhe dy deputetë që kanë pasur probleme shëndetësore, pra kanë pasur mungesa prezence në disa seanca, si dhe gjenden edhe deputetë të rinj, të zgjedhur rishtas, për shkak të ndryshimeve në përbërjen parlamentare, dhe për të cilët mund të ketë një alibi për vlerësimin negativ në renditjen e deputetëve pa diskutime e kontribute publike parlamentare.

6.3. KOMISIONE TË MBINGARKUARA, - SHKAK, BOJKOTI I OPOZITËS

Gjatë periudhës së bojkotit parlamentar të opozitës, mazhoranca u detyruar të përdorë deputetët e saj për të përmbushur detyrimin e nenit 34 të rregullores, sipas të cilit, “mbledhjet janë të vlefshme kur në to marrin pjesë më shumë se gjysma e të gjithë anëtarëve të komisionit”.

- ▶ Nga ekipi i ISP janë konstatuar rreth 10 raste kur komisionet e kanë pamundësuar mbledhjen pikërisht për shkak të mos arritjes së kuorumit të nevojshëm, - në tri raste kur bojkoti i një pale (edhe nga mazhoranca) ka ardhur për të pamundësuar mbledhjen e komisionit për një çështje të thirrur nga opozita, dhe në shtatë raste kur vetë mazhoranca ka pasur mungesë deputetësh për shkak të bojkotit të opozitës.
- ▶ Problematika që konstatohen në raste e tilla nuk lidhen vetëm me aspektin teknik (raste kur brenda të së njëjtës ditë, deputetë zëvendësues paraqiten në më shumë se një komision për të regjistruar emrin dhe kështu, për të mundësuar arritjen e kuorumit të mbledhjes), por edhe me aspektin përmbajtjesor.

KOMISIONI I ÇËSHTJEVE LIGJORE DHE ADMINISTRATËS

Fatmir Xhafaj	100%	Xhemal Qefalia	21%
Vasilika Hysi	85%	Gent Strazimiri	17%
Eduard Halimi	60%	Vexhi Muçmataj	15%
Tom Doshi	58%	Blendi Klosi	15%
Ulsi Manja	53%	Luljeta Arapi	8%
Dashamir Peza	51%	Adelina Rista	7%
Bashkim Fino	50%	Tahir Muhedini	6%
Petrit Vasili	50%	Mhill Fufi	5%
Anila Agalliu	49%	Arben Ristani	0%
Luan Rama	48%	Fatmir Mediu	0%
Pandeli Majko	37%	Nard Ndoka	0%
Edmond Leka	28%	Oerd Bylykbashi	0%
Silva Caka	26%	Shkelqim Troplini	0%
Piro Lutaj	21%	Armando Prenga	0%

Monitorimi: Efektiviteti i pjesëmarrjes në diskutime dhe në mbledhjet e komisionit

- Një numër deputetësh zëvendësues morën pjesë në komisione, profili i të cilave nuk ka lidhje direkt me formimin e tyre politik e profesional, dhe për pasojë, rastet kur deputetët zëvendësues janë përfshirë në diskutim ose kanë arritur të bëjnë ndonjë propozim/ndërhyrje/përmirësim në legjislacion në komisionin ku janë dërguar rishtas, janë minimale.

6.4. KOMISIONI I LIGJEVE, - VOLUM PUNE, POR VETËM 25% ISHIN EFEKTIVË

Bazuar në të dhënat e angazhimeve në debate dhe në pjesëmarrjen në komisionin e ligjeve rezultojnë se drejtuesit e komisionit (ish kryetari Xhafaj dhe pasuesja e tij Hysi) kanë pasur edhe efektivitetin më të lartë, përkatësisht 100 dhe 85%.

Surprizë është emri i katërt në listë, deputeti Doshi, i cili me angazhimet e tij në komision gjatë vitit 2017 ka lënë pas figurat më të njohura juridike të PS dhe të PD. Konkretisht shumë pas Doshit kanë tregues efektiviteti deputetët Vasili (kryetar i LSI), Majko, Rama, etj.

Nga deputetët e opozitës bie në sy fakti se figurat kryesore të saj në komision, sidomos Mediu, Ristani, Ndoka, Bylykbashki, etj, me gjithë pjesëmarrjet simbolike në mbledhjet e komisionit, nuk kanë pasur diskutime, propozime apo ndërhyrje, duke pasur rezultatin më të lartë negativ në gjithë përbërjen e këtij komisioni.

Të dhënat e këtij komisioni tregojnë se nga 28 anëtarë vetëm 7, përfshirë dy kryetarët e komisionit, kanë pasur efektivitet më të lartë sesa 49-50%. Pjesa tjetër e deputetëve, rreth tre të katërtat e tyre, kanë pasur efektivitet nën kuotën mesatare, ose janë tërësisht jo efektivë. Duke pasur parasysh se komisioni i ligjeve ka pasur objekt pune ligje me rëndësi të reformës në drejtësi dhe ligje organike ose vendimmarrje që lidhen me praktikën e zgjedhjeve në disa organe kushtetuese dhe të Presidentit të Republikës, është kritike raporti midis deputetëve efektivë dhe jo efektivë.

Nga 10 deputetët më aktiv të këtij komisioni, shtatë deputetë janë vendosur në vende të sigurta të listës proporcionale për rizgjedhje, dy të tjerë janë në pozita më pak të favorshme, njëri i pavarur dhe njëri në kufijtë fundorë të shanseve për zgjedhje. Peza e Agalliu nuk janë më pjesë e listës, ashtu si edhe deputetët e tjerë Lutaj, Mucmataj, etj.

6.5. KOMISIONI I SHËNDETËSISË, - DOMINIM DHE GARË MIDIS GRAVE DEPUTETE

Komisioni i Shëndetësisë dhe i Çështjeve sociale edhe në këtë sesion parlamentar u dominua nga bashkëkryetarët Vokshi e Spahiu, si dhe diskutimet intensive të disa prej grave të tjera deputete, ku dukshëm bëjnë diferencën Deda, Halimi, Arapi, Alhysa, etj.

Ky Komision ka nivelin më të lartë të efektivitetit bazuar në angazhimin e deputetëve dhe prezencën aktive në mbledhje. Konkretisht, shtatë deputetë, midis të cilëve, pesë nga PD dhe dy nga PS, kanë qenë kontribuues 100% në secilën nga seancat aktive të Komisionit. Nga ana tjetër, shtatë deputetë kanë rekorde negative, - asnjë ndërhyrje në komision për amendime ligjore,

KOMISIONI I SHËNDETËSISË DHE ÇËSHTJEVE SOCIALE

Albana Vokshi	100%	Ylli Ziçishti	38%
Albina Deda	100%	Adelina Rista	33%
Arbjola Halimi	100%	Andrea Marto	13%
Bedri Mihaj	100%	Omer Mamo	11%
Klodiana Spahiu	100%	Mesila Doda	0%
Luljeta Arapi	100%	Mirela Ferracaku	0%
Roland Keta	100%	Olta Xhaçka	0%
Illir Pendavinji	67%	Vangjel Tavo	0%
Bujar Kllogjeri	54%	Musa Ulqini	0%
Erjeta Alhysa	42%	Enkeleda Shkreli	0%
Eduart Bejko	38%	Bujar Çela	0%

Monitorimi: Efektiviteti i pjesëmarrjes në diskutime dhe në mbledhjet e komisionit

komente, pyetje apo forma të tjera të angazhimit të referueshëm.

Komisioni i Shëndetësisë ka shfaqur edhe këtë sesion një nivel problematik debati, përfshirë edhe midis grave deputete, me replika e akuza shpesh në limitet e etikës parlamentare, kryesisht për shkak të natyrës politike të drejtimit të tij dhe faktit se problematika e shëndetësisë ka qenë e mbetet temë thelbësore e debatit dhe e kontestimit publik në vend. Dy ministrat kryesorë që kanë fokus çështjet që mbulon ky komision, u ndryshuan në mars, ku tërhoqi vëmendjen shkarkimi i ministrit Klosi dhe promovimi në post ministror i një gruaje tjetër deputete, kryetares së organizatës së grave socialiste, Olta Xhaçka, e cila gjatë punimeve të këtij komisioni ka pasur efektivitet pune negativ.

Në listat elektorale 2017 partitë politike përjashtuan 7 nga 11 deputetët më aktiv, përfshirë katër nga gjashtë deputetët me treguesit më të lartë të efektivitetit parlamentar. Ky ndryshim radikal i listës dhe i përbërjes së komisionit edhe në parlamentin e ardhshëm nuk gjen përputhje me bilancin e vetë komisionit dhe nivelin e aktivitetit parlamentar.

6.6. KOMISIONI I JASHTËM: BILANC AKTIV, POR PENALIZIM NË RIKANDIDIM

Politika e jashtme ka pasur ngjarje të rëndësishme gjatë vitit 2017 dhe vetë Komisioni përkatës parlamentar ka bërë përpjekje të jetë aktiv në nivel komisioni dhe në nivel përfaqësimi ndërkombëtar. Megjithatë referuar të dhënave mbi efektivitetin, rezulton se vetëm 50% e anëtarëve kanë pasur kuota pozitive, dy deputetë kanë kuota minimale dhe pesë të tjerë kanë kuota negative.

Ky komision ka pasur në përbërje të tij disa ish ministra të jashtëm dhe figura me rëndësi politike, por vetëm një pjesë e tyre kanë qenë aktiv në pjesëmarrje dhe në debatet profesionale apo politike. Përfaqësim maksimal ka deputeti më me shumë mandate deri 2017, Namik Dokle, po aq sa vetë drejtuesit e Komisionit, ndërkohë që nga opozita është përfaqësuar më aktivisht nga ish kryetarët e Kuvendit, Topalli dhe Islami.

Ndër komisionet parlamentare ky është komisioni më i ndëshkuar nga liderit politikë në përcaktimin e listës së re proporcionale për zgjedhje më 2017. Konkretisht, nga shtatë deputetë më aktiv pesë nuk janë përfshirë në listën e ri-kandidimit, - vlerësimi më negativ që i është bërë një trupe parlamentare. Në rastin konkret më shumë sesa vlerësim për funksionin dhe angazhimin, dorëheqjet nga lista apo përjashtimi prej saj erdhën kryesisht për shkak të

KOMISIONI I POLITIKËS SË JASHTME

Arta Dade	100%	Luljeta Arapi	7%
Namik Dokle	100%	Ben Blushi	0%
Taulant Balla	100%	Vangjel Dule	0%
Jozefina Topalli	67%	Anila Agalliu	0%
Valentina Leskaj	50%	Esmeralda Shkaj	0%
Kastriot Islami	43%	Silva Caka	0%
Aldo Bumçi	40%	Sheptim Idrizi	0%
Edlira Çekrezi	8%	Eduart Selami	0%

Monitorimi: Efektiviteti i pjesëmarrjes në diskutime dhe në mbledhjet e komisionit

nivelit të personaliteteve kritike në këtë komision, kritik ndaj politikës zyrtare të dy kryetarëve të partive të mëdha politike.

6.7. KOMISIONI I MEDIAS, BILANC FORMAL NË MBLEDHJE DHE NË PRODUKTIVITET

Komisioni i Medias është një prej komisioneve që drejtohet nga opozita, e cila në tërësi ishte në bojkot politik parlamentar gjatë pjesës më të madhe të aktivitetit parlamentar janar-maj 2017. Megjithatë, në dallim nga përvoja e sesioneve të tjera parlamentare gjatë 2016, disa deputetë ishin aktiv në pjesëmarrje dhe debate, duke ndryshuar raportet e angazhimit brenda komisionit. Konkretisht, tre deputetë, patën vlerësim maksimal të efikasitetit në komision, ndjekur edhe nga deputetë si Hoxha, pa lidhje me median dhe sektorin e arsimit apo edukimit.

Gjithashtu aktiv ishin deputetët Hafizi e Mehmetaj, Tafaj e Ulqini, Rista dhe

KOMISIONI I MEDIAS DHE EDUKIMIT

Genc Pollo	100%	Evis Kushi	25%
Fatmir Toçi	100%	Eleina Qirici	20%
Luçiano Boçi	100%	Erjeta Alhysa	14%
Alfred Peza	80%	Enkelejda Shkrelly	0%
Bedri Hoxha	80%	Dashamir Kamberi	0%
Mimoza Hafizi	67%	Anila Agalliu	0%
Kejdi Mehmetaj	60%	Besnik Baraj	0%
Myqerem Tafaj	60%	Mira Shehu	0%
Musa Ulqini	56%	Gentian Bejko	0%
Adelina Rista	40%	Andrea Marto	0%
Fidel Ylli	33%	Blerina Gjylameti	0%
Astrit Veliaj	25%	Agron Çela	0%
		Gjovalin Bzheta	0%

Monitorimi: Efektiviteti i pjesëmarrjes në diskutime dhe në mbledhjet e komisionit

Ylli, Veliaj dhe Kushi. Ndërkohë në tabelë pasqyrohen deputetët që kanë tregues negativ të efektivitetit në komision, kryesisht deputetë të PS dhe figura drejtuese të kësaj partie. Dy deputetët e Shkodrës, Çela e Bzheta, nuk morën pjesë në asnjë prej mbledhjeve të komisionit dhe për pasojë, kanë zero kontribut edhe në debatet dhe vendimmarrjet e tij.

Vlen të theksohet se axhenda e komisionit ka qenë minimaliste, kryesisht në akte protokollare dhe pa nisma konkrete ligjore dhe pa arritur të luajë rol aktiv në rritjen e standardeve të medias në vend dhe në rritjen e cilësisë dhe mbështetjes parlamentare në institucionet e edukimit dhe të shkencës. Reforma në institucionet shkencore mbeti jashtë rendit të ditës, kurse akte të shumta të reformës në arsim vijnë të jenë në muaj e vite jashtë afatit të përcaktuar nga ligji organik mbi arsimin e lartë.

Referuar listës zyrtare të kandidatëve për parlamentin e ri, rezulton se dy deputetët e majtë më aktiv në këtë komision janë përjashtuar nga lista e ri-kandidimit, siç edhe katër nga deputetët me kontribut zero në komision, janë rikandiduar në zona fituese për parlamentin e ri. Ky është një detaj tjetër që dëshmon se kontributi në komision dhe efektiviteti parlamentar nuk ka qenë kriter me rëndësi në vendimin politik të subjekteve përkatëse për rikandidimin ose jo të deputetëve anëtarë të këtij komisioni.

6.8. KOMISIONI I SIGURISË, - REZULTATE MINIMALE, DHE 50% TË HESHTUR

Komisioni i Sigurisë ka qenë një prej komisioneve më të kontestuara në përbërje gjatë legjislaturës së kaluar. Bilanci i punës së tij gjatë vitit 2017 është simbolik, dhe se siç u pranua edhe në mbledhjen e fundit të tij, një sërë sfidash e përgjegjësish për kontrollin kushtetues të institucioneve të sigurisë nuk është përmbushur.

Referuar të dhënave krahasuese me përjashtim të dy drejtuesve të komisionit, gjysma tjetër e tij ishte aktive në pjesëmarrje e debate në komision. Konkretisht, deputetë aktiv nga PS ishin Lutaj, Qefalia, Ndreu, Sterkaj, Çuko, Manja, etj, nga PD ishte Dogjani, si dhe nga LSI ishte Çelaj. Nga ana tjetër tetë deputetë nuk ishin aktiv dhe kanë rekorde negative të efektivitetit të tyre. Midis tyre bëjnë pjesë dy emra që kanë rikandiduar në zgjedhje me shanse maksimale për tu rizgjedhur, si dhe ndonjë deputet me kontribut pozitiv në debatet në seancat plenare.

KOMISIONI I SIGURISË KOMBËTARE

Spartak Braho	100%	Flamur Çelaj	40%
Flamur Noka	100%	Anduel Xhindi	0%
Piro Lutaj	71%	Shkëlqim Troplini	0%
Xhemal Qefalia	71%	Alban Zeneli	0%
Pjerin Ndreu	60%	Ylli Shehu	0%
Paulin Sterkaj	60%	Astrit Patozi	0%
Arben Çuko	57%	Keltis Kruja	0%
Asllan Dogjani	50%	Aqif Rakipi	0%
Ulsi Manja	50%	Gjovalin Kadeli	0%

Monitorimi: Efektiviteti i pjesëmarrjes në diskutime dhe në mbledhjet e komisionit

Nga lista e deputetëve me efektivitet më të lartë janë përjashtuar nga rikandidimi tre prej tyre, ku bien dukshëm në sy dy deputetët më aktiv të mazhorancës dhe të opozitës, përjashtuar dy bashkëkryetarët e Komisionit.

6.9. KOMISIONI I VEPRIMTARIVE PRODHUESE: ATY KU PRURJET NGA BIZNESI JANË INAKTIVË

Në Komisionin e Veprimtarive Prodhuese dhe Tregtisë ka rekord diskutimesh, siç ka edhe rekord të numrit të deputetëve “të heshtur”, që kanë zero efektivitet. Në listën e paraqitur pjesë e deputetëve me vlerësim negativ janë emra të njohur, kryesisht të së majtës dhe kryesisht biznesmenë, të cilët kanë pasur rol zëvendësues ose protokollar në mbledhjet e komisionit.

Nga lista e individëve më me shumë angazhime dhe efikasitet parlamentarë në këtë Komision, përveç kryetarit dhe pasuesit të tij, bien në dy emra të deputetëve të mazhorancës dhe të opozitës që janë përjashtuar nga lista e kandidimit 2017, siç janë Dashi, Ruli, Bushati, Hajdarmataj, Papa të PD-së Kopliku, Toci, Gaci, etj, të PS-së.

Vetëm gjashtë deputetë kanë angazhim më të lartë se 50%, ndërkohë që 13

KOMISIONI I VEPRIMTARISË PRODHUESE DHE TRËGTISË

Eduard Shalsi	100%	Rakip Suli	14%
Kozma Dashi	67%	Agron Duka	9%
Besnik Baraj	55%	Ervin Bushati	7%
Genc Ruli	55%	Bujar Derveni	7%
Namik Kopliku	50%	Mira Shehu	0%
Gjergji Papa	50%	Irma Kopliku	0%
Helidon Bushati	40%	Parid Cara	0%
Mimoza Hajdarmataj	36%	Vladimir Kosta	0%
Fatmir Toçi	32%	Piro Kapurani	0%
Artan Gaçi	23%	Edmond Zejno	0%
Gentian Bejko	21%	Dashamir Kamberi	0%
Petrit Gjoni	20%	Eduart Bejko	0%
Robert Bitri	17%	Ilirian Pendavinji	0%
Bujar Çela	15%	Anduel Xhindi	0%

Monitorimi: Efektiviteti i pjesëmarrjes në diskutime dhe në mbledhjet e komisionit

deputetë, ose 50% e tyre kanë angazhim më pak se 10%, ku spikasin shtatë deputetët me kontribut zero.

Ky komision është përballur edhe këtë sesion me debatin mbi ligjin e importit të plehrave dhe debate të tjera të rëndësishme që kanë të bëjnë me projekte ekonomike me impakt publik, por në tërësi rezultati pozitiv i drejtimit gjatë vitit 2016 shënoi hapa negativ gjatë 2017, duke shkruar shpeshherë në debate verbale dhe një klimë të theksuar kontestimi midis anëtarëve, mbi bazën e përkatësisë politike.

6.10. KOMISIONI EKONOMI – FINANCE: EFEKTIVITET MINIMAL, REKORD RIKANDIDIMI

Komisioni i Ekonomisë dhe i Financës edhe këtë sesion parlamentar ka pasur

KOMISIONI EKONOMI DHE FINANCE

Erjon Braçe	100%	Luan Duzha	8%
Ridvan Bode	100%	Shkelqim Cani	0%
Ervin Bushati	53%	Gledjon Rehovica	0%
Anastas Angjeli	38%	Dashamir Shehi	0%
Ervin Koçi	36%	Edmond Spaho	0%
Evis Kushi	32%	Florion Mima	0%
Blerina Gjylameti	29%	Igli Cara	0%
Dhurata Çupi	25%	Jorida Tabaku	0%
Andrea Marto	22%	Liljana Elmazi	0%
Perparim Spahiu	20%	Arben Çuko	0%
Xhevit Bushaj	20%	Ilir Xhakolli	0%
Antoneta Dhima	12%	Paulin Sterkaj	0%
Gjovalin Kadeli	10%	Pjerin Ndreu	0%

Monitorimi: Efektiviteti i pjesëmarrjes në diskutime dhe në mbledhjet e komisionit

një axhendë të ngjeshur me mbledhje dhe diskutime, kryesisht referuar projektligjeve specifike apo seancave dëgjimore me institucionet financiare në varësi të Kuvendit. Referuar të dhënave të angazhimit të anëtarëve të Komisionit në mbledhje (prezencë dhe pjesëmarrje në debate, propozime apo ngritje problematikash), rezulton se dy drejtuesit kryesorë Brace e Bode kanë pasur eficiencë maksimale në prezencat e tyre, ndjekur nga figurat kryesore ekonomike të PS. Në total vetëm 3 deputetë kanë rezultat efektiviteti më të lartë se 50%, ku krahas drejtuesve të dy palëve bën pjesë ish ministri Angjeli.

Niveli i angazhimit të deputetëve të opozitës është shumë më i ulët, dhe nuk e kalon kuotën 25%, ndërkohë që 12 deputetë, përfshirë dy ish ministra financash, Mima e Cani, apo ish ministra në sektorë të rëndësishëm të ekonomisë, si Shehi e Spaho, kanë pasur prezencat të ndryshme në mbledhje, por nuk kanë lënë asnjë gjurmë debati, pjesëmarrje në diskutime, propozime amendime apo forma të tjera të angazhimit në komision. I njëjti vlerësim vlen edhe për një pjesë të deputetëve zëvendësues të majtë, kryesisht individë pa formim ekonomik, si dhe emra të tjera, kryesisht të opozitës, si Elmazi, Cara, etj.

Referuar listës proporcionale të ri-kandidimit vlen të theksohet se nga 10 deputetët më aktiv të këtij komisioni nuk është përfshirë vetëm deputeti

Ruli, (dorëheqje), treguesi më i lartë i ri-kandidimit bazuar në përbërjen e komisioneve parlamentare.

6.11. INTEGRIMI, - MBLEDHJE MINIMALE, TRE DISKUTUES DHE PESË TË HESHTUR

Komisioni i Integrimit Evropian bën pjesë në ato komisione me aktivitet minimal dhe simbolik. Megjithëse gjatë 2017 aktiviteti politik në raport me BE dhe institucionet ndërkombëtare ishte mjaft intensiv, vetë Komisioni nuk kishte një axhendë intensive dhe nuk i përdori sa duhet mekanizmat në dispozicion për të ndikuar në rrjedhën politike dhe në ecurinë më pozitive të zhvillimeve në raport me institucionet evropiane.

Sipas të dhënave të Komisionit dy drejtuesit kryesorë Bregu e Balla kanë pasur pjesëmarrje maksimale në mbledhje e në debate, kurse nga anëtarët e tjerë ka vetëm një rast të pjesëmarrjes aktive.

KOMISIONI I INTEGRIMIT EVROPIAN

Majlinda Bregu	100%	Esmeralda Shkja	0%
Taulant Balla	100%	Ilir Xhakolli	0%
Bujar Derveni	25%	Sadri Abazi	0%
Gramoz Ruçi	0%	Namik Dokle	0%

Monitorimi: Efektiviteti i pjesëmarrjes në diskutime dhe në mbledhjet e komisionit

Të paktën pesë anëtarët e tjerë të komisionit, përfshirë kryetarin e grupit më të madh parlamentar, kanë qenë pjesëmarrës në disa prej mbledhjeve por nuk kanë marrë pjesë aktive në asnjë prej diskutimeve të zhvilluara aty.

Referuar listës së ri-kandidimit në zgjedhjet 2017, rezulton se kryetarja Bregu është përjashtuar nga mundësia e ri-kandidimit, - rasti i vetëm i përjashtimit të një kryetari/kryetare komisioni në parlament. Jashtë listës janë edhe disa anëtarë të tjerë të komisionit, - tregues që nuk lidhet me punën e komisionit, por me kriteret e tjera partiake dhe lojaliteti ndaj drejtuesit politik.

DEPUTETIM.al



Netherlands
Embassy
in Albania

Instituti i Studimeve Politike do të kryejë monitorimin aktiv të parlamentit gjatë periudhës shtator 2017 – shtator 2020 përmes platformës online www.deputetim.al

RISITË DHE PROBLEMATIKAT E LIGJEVE

Informohuni më për përdorimin e axhendës legislative
SHIKO LIGJET



PROJEKTLIGJ



LIGJE TE MIRATUARA



Deputeti im

Jetëshkrimi, angazhimi
parlamentar, votimi
deklarime, transparenc



Transparenca
financiare

Deklarimet e pasurisë,
trajtimi financiar,
transparenca e
institucionit



Gratë Deputete

Aleanca e Grave
Deputete, problematikat
gjinore, bilanci e
angazhimit



Grupet
Parlamentare

Përbërja, funksionimi,
vendimmarrja, risitë dhe
problemet



Institucionet e
Pavarura

Zgjedhja e institucioneve
të pavarura, monitorimi
vjetor, marrëdhëniet



Sondazhe dhe
vlerësime

Besimi në institucion,
perceptimi publik mbi
Kuvendin

Gjetjet Kryesore

REPORT MONITORUES
JANAR - QERSHOR 2017

71

KUVENDI I SHQIPËRISË 2017

BILANCI I AKTIVITETIT DHE PROBLEMATIKAT

RAPORT MONITORUES JANAR - QERSHOR 2017



ISBN 978-9928-215-18-5